

Pako e materialeve për Edukimin Medial, Bullizmin Kibernetik dhe Gjuhën e Urrejtjes

Dokument shoqërues i
Manualit për Edukimin Medial dhe Dezinformimin për të Rinj në Kosovë


Për përdorim në klasë, punëtori rinore, trajnim të bashkëmoshatarëve dhe aktivitete të organizatave rinore.
Grupmosha e synuar: 15-29 vjeç

Ministria e Sportit dhe Rinisë
Ministarstvo Sporta i Omladine
Ministry of Sport and Youth

Dokument shoqërues i Manualit për Edukimin Medial dhe Dezinformimin për të Rinj në Kosovë

Për përdorim në klasë, punëtori rinore, trajnim të bashkëmoshatarëve dhe aktivitete të organizatave rinore.

Grupmosha e synuar: 15-29 vjeç



Mohim përgjegjësie

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të projektit Laboratori Rinor i Ballkanit Perëndimor, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC). Ai është hartuar me iniciativën e Grupit të Punës për Dezinformimin dhe Edukimin Mediatik nga Kosova, të themeluar në kuadër të Laboratorit Tematik të Politikave Rinore.

Përgjegjësia për përmbajtjen, pikëpamjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument i takon vetëm autorit(ëve) dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, pjesëmarrësve, partnerëve, donatorëve të tij apo të Bashkimit Evropian.

Shënim mbi përdorimin

Kjo pako e materialeve është ndërtuar me qëllim zgjerimin e kuptimit të kapitujve të Manualit për Edukimin Medial dhe Dezinformimin për të Rinj në Kosovë. Si i tillë, pakoja e materialeve nuk duhet të shihet si zëvendësim i manualit. Trajneri/fasilituesi duhet të përdorë shpjegimet konceptuale të manualit dhe mjetet praktike të këtij dokumenti si elemente plotësuese të cilat ofrojnë kuptim më të saktë e më të zgjeruar të moduleve.

Personat të cilët do të punojnë me këtë manual, apo të ftuarit gjatë sesioneve trajnuese të ndryshme duhet të zotërojnë aftësi të mira komunikuese dhe të përdorin gjuhë miqësore me të rinjtë, duke shmangur fjalët teknike ose të komplikuara. Ndër tjerash ata/ato duhet të krijojnë një ambient të sigurtë psikologjik dhe emocional për të rinjtë, të zhvillojnë sesionet me ndjeshmëri emocionale, të krijojnë hapësira për ndërveprim dhe mbledhje të ideve të të rinjve gjatë gjithë kohës si dhe të mundësojnë që formati dhe ambienti të përshtaten në formë që nxit pjesëmarrjen aktive të pjesmarrësve.

Të gjitha rastet dhe pretendimet në pakon e materialeve janë raste edukative të simuluara, të frymëzuar nga mënyrat se si qarkullon informacioni në Kosovë dhe në rajon. Ato nuk synojnë të identifikojnë persona, media, institucione apo komunitete konkrete.

Parimi "mos shkakto dëm"

Mos përdorni në trajnim përmbajtje që identifikon të mitur, viktima të dëmtimit online ose persona të zakonshëm. Mos riprodhoni gjuhë urrejtjeje, pamje poshtëruese apo materiale intime. Kur një rast real është i nevojshëm, anonimizoni emrat, fotografitë, vendin dhe detaje të tjera identifikuese.

Baza metodologjike

Pakoja e materialeve i kombinon tri shtylla të UNESCO-s për edukimin medial dhe informativ, përkatësisht: i) kuptimin e rolit të mediave dhe ofruesve të informacionit; ii) vlerësimin kritik të përmbajtjes dhe; iii) prodhimin e përdorimin etik të përmbajtjes. Po ashtu i referohet praktikave edhe udhëzuesve të UNICEF dhe Këshillit të Evropës për bullizmin kibernetik dhe gjuhën e urrejtes.

Kjo pako materialesh përdor qasje të përqendruar te nxënësi/ja (pjesmarrësit) dhe udhëhiqet nga qasja e të nxënit përmes praktikës, reflektimit, punës në grupe dhe edukimit nga bashkëmoshatarët (Peer-to-Peer learning).

Nga modeli i manualit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), përkatësisht "Work Wise Youth", është marrë logjika e zbatimit të një sesioni:

- rezultatet e të nxënit
- koha
- materialet
- përgatitja
- udhëzimet hap pas hapi
- diskutimi përmbyllës
- mesazhet kyçe
- fletët e punës
- skenarët me role
- përfshirja e ekspertit të ftuar dhe vlerësimi para/pas trajnimit.

Përmbajtja e ushtrimeve të kësaj pakoje të materialeve është zhvilluar posaçërisht për edukimin medial dhe dezinformimin në kontekstin e të rinjve në Kosovë.

Përmbajtja

Shënim mbi përdorimin 3

Baza metodologjike 4

Përmbajtja 5

1. Si përdoret pakoja e materialeve 7

1.1 Struktura e secilit mjet 7

1.2 Rregullat e hapësirës së sigurt 8

1.3 Përgatitja e shembujve 8

2. Harta e mjeteve praktike 9

3. Mjetet për Kapitullin III - Aftësia mediatike dhe konsumi kritik 12

MJETI 1 - Rrjedha ime e informacionit 12

MJETI 2 - Pesë pyetjet për çdo mesazh mediatik 15

MJETI 3 - Lajm, opinion, reklamë, satirë apo propagandë? 17

MJETI 4 - I njëjti rast, tri paraqitje 19

MJETI 5 - Laboratori i titullit, fotografisë dhe kontekstit 21

MJETI 6 - Redaksia e përgjegjshme 23

4. Mjetet për Kapitullin IV - Identifikimi dhe reagimi ndaj keqinformimit dhe dezinformimit 25

MJETI 7 - Radari i sinjaleve paralajmëruese 25

MJETI 8 - Leximi anësor: dil nga faqja dhe kontrollo burimin 28

MJETI 9 - Detektivi i kontekstit: fotografi dhe video 30

MJETI 10 - Dosja e verifikimit të një pretendimi 32

MJETI 11 - Ekipi i reagimit: Ndalo - Ruaje - Verifiko - Vlerëso - Reago - Mëso 34

MJETI 12 - Korrigjo pa e amplifikuar 36

MJETI 13 - Parandalimi i manipulimit: laboratori i prebunking-ut 38

MJETI 14 - Përmbajtja me IA: nga dyshimi te verifikimi 40

5. Mjete për Kapitullin V - Bullizmi Kibernetik 42

MJETI 15 - Personazhe të njohur dhe bullizmi kibernetik 42

MJETI 16 - Pyetsor dhe skenarë mbi bullizmin kibernetik 45

MJETI 17 - Bullizëm kibernetik apo justifikime 47

MJETI 18 - Ku qëndron ti në një situatë bullizmi kibernetik 49

MJETI 19 - Fjalitë e keqkuptuara 51

MJETI 20 - Teatër pjesëmarrës në situatë bullizmi kibernetik 53

MJETI 21 - Simulim raportimi i bullizmit kibernetik: Si ta njohim, dokumentojmë dhe raportojmë ngacmimin online mes moshatarëve 56

6. Mjete për Kapitullin VI - Gjuha e Urrejtjes 59

MJETI 22 - Kush është shënjestra, analizë e rasteve të anonimizuara të gjuhës së urrejtjes 59

MJETI 23 - Gjurmët digjitale, si "ndjek" një postim lëndues për vite me radhë 62

MJETI 24 - Përmbajtja e gjeneruar nga IA dhe gjuha e urrejtjes nëpër platforma 65

MJETI 25 - Lojë me role: "Nga ekrani im te ekrani i gjithkujt" 68

MJETI 26 - Simulim raportimi: Si të raportosh, bllokosh dhe dokumentosh abuzimin online 72

MJETI 27 - Rasti Vejdeland kundër Suedisë - Kur gjuha e urrejtjes në shkollë përfundon në gjykatë 74

7. Paketa të gatshme për trajnim 77

7.1 Edukimi Medial 78

7.2 Bullizmi kibenetik 78

7.3 Gjuha e urrejtjes 79

7.4 Shembull agjende për një ditë 79

8. Përfshirja e ekspertit të ftuar 81

8.1 Pyetje për ekspertin 82

9. Vlerësimi i të nxënit 83

9.1 Rubrika e performances 84

Fletët e punës dhe anekset 84

Aneksi 1 - Ditari 24-orësh i informacionit 85

Aneksi 2 - Pesë pyetjet për mesazhin mediatik 86

Aneksi 3 - Kartat e klasifikimit të përmbajtjes 87

Aneksi 4 - Kontrolli anësor i burimit 88

Aneksi 5 - Dosja e verifikimit 89

Aneksi 6 - Matrica e dëmit dhe reagimit 90

Aneksi 7 - Korrigjimi "fact-first" 91

Aneksi 8 - Canvas-i i prebunking-ut 92

Aneksi 9 - Testi para/pas 93

Aneksi 10 - Formulari i feedback-ut 94

Aneksi 11 - Lista e kontrollit për fasilituesin 95

Aneksi 12 - Plani personal "Mëso - Praktiko - Ndaj" 96

Aneks 13 Kartat e Situatave Fiktive - Bullizmi Kibernetik 97

Aneks 14 - "Postimi Shembull" + Menuja e Raportimit 100



1. Si përdoret pakoja e materialeve

Pakoja e materialeve është modulare, që nënkupton që trajnerët/fasilituesit mund të zgjedhin një ushtrim të vetëm për një orë mësimore, të kombinojnë disa mjete në një punëtori gjysmëditore, ose të zhvillojnë një punëtori të plotë një apo dy-ditore. Mjetet nuk duhet të zbatohen domosdoshmërisht sipas renditjes së dokumentit.

1.1 Struktura e secilit mjet

Elementi	Çfarë tregon
Lidhja me manualin	Konceptet dhe pjesa e kapitullit që operacionalizon ushtrimi.
Qëllimi	Problemi praktik që trajtohet.
Rezultatet e të nxënit	Çfarë duhet të jetë në gjendje të bëjë pjesëmarrësi në fund të sesionit
Koha dhe formati	Kohëzgjatja, madhësia e grupit dhe niveli i vështirësisë.
Materialet dhe përgatitja	Çfarë duhet të sigurohet para sesionit.
Hapat	Udhëzimet e zbatimit në rend kronologjik.


Elementi	Çfarë tregon
Reflektimi	Pyetjet që e kthejnë aktivitetin në të nxënë të vetëdijshëm.
Mesazhet kyçe	Pikat që fasilituesi duhet t'i përforcojë.
Përshtatja	Variantet online, offline dhe sipas grupmoshës.
Siguria	Kufijtë etikë dhe mënyrat për të shmangur dëmin.

1.2 Rregullat e hapësirës së sigurt

- Analizojmë përmbajtjen dhe taktikën: nuk turpërojmë personin që mund ta ketë besuar ose shpërndarë.
- Nuk kërkojmë nga pjesëmarrësit të tregojnë përvoja personale të dëmtimit online.
- Nuk përdorim shembuj që mund të rindezin tensione politike, etnike, fetare apo gjinore pa përgatitje dhe moderim të kujdesshëm.
- Kur nuk ka prova të mjaftueshme, përdorim përfundimin "e pavërtetuar", jo një verdikt të hamendësuar.
- Ruajmë privatësinë: nuk publikojmë fletët e punës, ekranet apo deklaratat e pjesëmarrësve pa pëlqim.
- Kritika duhet të jetë e bazuar në prova dhe e drejtuar ndaj pretendimit, jo ndaj identitetit ose dinjitetit të personit.

1.3 Përgatitja e shembujve

Përdor	Shmang
Skenarë të simuluar dhe të anonimizuar.	Postime që identifikojnë të mitur ose viktima.
Tituj, grafikë dhe postime të krijuara posaçërisht për trajnim.	Riprodhim të plotë të gjuhës së urrejtjes apo përmbajtjes poshtëruese.
Raste publike vetëm kur janë të verifikuara dhe kanë vlerë të qartë pedagogjike.	Raste të freskëta që mund të jenë ende në zhvillim ose të nxisin konflikt.
Burime të ndryshme dhe këndvështrime të krahasueshme.	Shembuj ku përgjigjja varet vetëm nga bindja politike e pjesëmarrësit.
Materiale të lexueshme edhe pa pajisje digjitale.	Ushtrime që dështojnë plotësisht nëse interneti nuk funksionon.



2. Harta e mjeteve praktike

Nr.	Mjeti	Kapitulli	Kompetenca kryesore	Koha
1	Rrjedha ime e informacionit	III	Vetëdijesim mbi burimet, emocionin dhe zakonet	45-60 min
2	Pesë pyetjet për çdo mesazh mediatik	III	Analizë kritike e një mesazhi	50-70 min
3	Lajm, opinion, reklamë, satirë apo propagandë?	III	Dallim i llojeve të përmbajtjes	40-55 min
4	I njëjti rast, tri paraqitje	III	Framing (kornizim), përzgjedhje dhe mungesa	60-75 min
5	Laboratori i titullit, fotografisë dhe kontekstit	III	Etikë, tituj dhe imazhe	55-70 min
6	Redaksia e përgjegjshme	III	Vendimmarrje editoriale nën presion	75-90 min
7	Radari i sinjaleve paralajmëruese	IV	Njohja e shenjave të dyshimit	35-50 min
8	Leximi anësor	IV	Vlerësimi i burimit dhe reputacionit	45-60 min

Nr.	Mjeti	Kapitulli	Kompetenca kryesore	Koha
9	Detektivi i kontekstit	IV	Verifikim i fotografisë dhe videos	55-75 min
10	Dosja e verifikimit	IV	Fact-checking i strukturuar	75-100 min
11	Ekipi i reagimit	IV	Vlerësim i dëmit dhe zgjedhje e reagimit	70-90 min
12	Korrigjo pa e amplifikuar	IV	Mesazh korrigjues "fact-first"	45-60 min
13	Laboratori i prebunking-ut	IV	Njohja paraprake e taktikave manipuluese	60-75 min
14	Përmbajtja me AI	IV	Verifikim, pasiguri dhe komunikim i kujdesshëm	60-80 min
15	Personazhe të njohur dhe bullizmi kibernetik	V	Identifikimi i bullizmit kibernetik	60 min
16	Pyetsor dhe skenarë mbi bullizmin kibernetik	V	Identifikimi i njohurive/boshllëqeve në bullizmin kibernetik	40 min
17	Bullizëm kibernetik apo justifikime	V	Vlerësm i situatës nëse është bullizëm apo shaka dhe impakti që ka tek të rinjtë	30 min
18	Ku qëndron ti në një situatë bullizmi kibernetik	V	Diskutim në grup mbi kufirin mes shakasë dhe bullizmit kibernetik.	60 min
19	Fjalitë e keqkuptuara	V	Reflektimi mbi dëmin emocional, psikologjik dhe impaktin e bullizmit kibernetik në një viktimë të tij.	30 min
20	Teatër pjesëmarrës në situatë bullizmi kibernetik	V	Nxitja e reagimit dhe ndalimit të bullizmit kibernetik nëpërmjet një simulimi situate.	80 min
21	Simulim raportimi i bullizmit kibernetik: Si ta njohim, dokumentojmë dhe raportojmë ngacmimin online mes moshatarëve	V	Njohja e situatave të bullizmit kiberneik dhe reagimi proporcional ndaj situatave.	45-60 min
22	Kush është shënjestra, analizë e rasteve të anonimizuara të gjuhës së urrejtjes	VI	Njohja me koncpetin e gjuhës së urrejtjes dhe kategoritë/grupet më të prekura.	60 min
23	Gjurmët digjitale, si "ndjek" një postim lëndues për vite me radhë	VI	Njohja me koncpetin e gjuhës së urrejtjes dhe gjurma digjitale e saj.	45-60 min
24	Përmbajtja e gjeneruar nga IA dhe gjuha e urrejtjes nëpër platforma	VI	Reflektim mbi situatat ku gjuha e urrejtjes shpërndahet në platforma të ndryshme dhe se si përdorimi i IA mund të amplifikojë gjuhën e urrejtjes online.	45-60 min
25	Lojë me role: "Nga ekrani im te ekrani i gjithkujt"	VI	Reflektim mbi situatat ku gjuha e urrejtjes shpërndahet në platforma të ndryshme dhe se si përdorimi i IA mund të amplifikojë gjuhën e urrejtjes online.	45-60 min

Nr.	Mjeti	Kapitulli	Kompetenca kryesore	Koha
26	Simulim raportimi: Si të raportosh, bllokosh dhe dokumentosh abuzimin online	VI	Ushtrim me hapa prikatikë për raportimin dhe mbrojtjen në platforma digjitale nga gjuha e urrejtjes.	45 min
27	Rasti Vejdeland kundër Suedisë: Kur gjuha e urrejtjes në shkollë përfundon në gjykatë	VI	Njohja me një rast konkret të gjuhës së urrejtjes në ambient shkolle dhe kuadrin rajonal Evropian ligjor të aplikueshëm	60 min

Rruga e rekomanduar e të nxënit

Nis me vetëdijesimin për zakonet personale, vazhdo me analizën e përmbajtjes, pastaj praktiko re-agimin, korrigjimin dhe parandalimin.



3. Mjetet për Kapitullin III - Aftësia mediatike dhe konsumi kritik

Këto mjete i ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë mjedisin mediatik, të dallojnë llojet e përmbajtjes, të analizojnë framing-un dhe të praktikojnë prodhimin etik të mesazheve.

MJETI 1 - Rrjedha ime e informacionit

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli III: media si mjedis dhe konsumi kritik	45-60 min	Individual + grupe 3-4	Hyrës

Qëllimi

To help participants see that their information diet is made up not only of “news”, but of a mix of sources, platforms, emotions and interactions.

Materialet

- Fleta e punës "Ditari 24-orësh i informacionit" (Aneksi 1);
- stilolapsa ose dokument i përbashkët online;
- flipchart ose tabelë për përmbledhjen e modeleve.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit një shembull personal, por jo shumë privat, për të demonstruar plotësimin e fletës.
- Shpjego se pjesëmarrësit mund të përdorin shembuj të përgjithshëm dhe nuk duhet të tregojnë përmbajtje private.

Hapat e zbatimit

1. Hap sesionin me pyetjen: "Cila ishte përmbajtja e parë që pe sot dhe kush vendosi që ta shihje?" Mblidh 4-5 përgjigje pa komentuar.
2. Pjesëmarrësit rikujtojnë 8-10 përmbajtje që kanë parë gjatë 24 orëve: lajm, video, postim, reklamë, meme, mesazh në grup ose njoftim institucional.
3. Për secilën përmbajtje plotësojnë: platformën, burimin, qëllimin e mundshëm, emocionin e parë, veprimin e tyre dhe nëse e verifikuan.
4. Në grupe të vogla, pjesëmarrësit kërkojnë modele: cilat platforma dominojnë; sa përmbajtje kishin autor të qartë; sa veprime ishin impulsive.
5. Çdo grup zgjedh një përfundim dhe një "zakon të ri": p.sh. të lexojë përtej titullit, të kontrollojë datën ose të mos shpërndajë gjatë zemërimit.
6. Përmbylle me një "biletë dalje": secili shkruan një fjali - "Nga sot, para se të _____, do të _____."

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cili burim kishte më shumë ndikim, edhe pse nuk e konsideronit "media"?
- Në cilat raste emocioni erdhi para kuptimit të përmbajtjes?
- Sa shpesh platforma e zgjodhi përmbajtjen për ju?
- Cili ndryshim i vogël është realist për javën e ardhshme?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor karta me ikona të platformave dhe llojeve të përmbajtjes; pjesëmarrësit i vendosin në një vijë kohore.
Online	Përdor formular anonim dhe paraqit rezultatet e agreguara në ekran.
Mosha 15-17	Kufizoje në gjashtë përmbajtje dhe përdor kategori me ikona.
Mosha 18-29	Shto pyetjen për interesin ekonomik, politik ose institucional të burimit.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos kërko të hapen biseda private, mesazhe personale apo profile. Pjesëmarrësi mund ta përshkruajë përmbajtjen pa treguar ekranin.

MJETI 2 - Pesë pyetjet për çdo mesazh mediatik

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli III, seksioni 4.1	50-70 min	Grupe 4-5	Hyrës-mesatar

Qëllimi

Të kthejë pesë pyetjet e manualit në një rutinë të përdorshme për analizimin e postimeve, artikujve, video-ove, reklamave dhe mesazheve publike.

Materialet

- Një postim i simuluar: "Bursa e re që do ta ndryshojë jetën e çdo studenti - apliko sot!" me logo, fotografi dhe lidhje të paqartë;
- Fleta "Pesë pyetjet" (Aneksi 2);
- pesë flipchart-e ose pesë seksione në dokument online.

Përgatitja e fasilituesit

- Sigurohu që shembulli të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për analizë, por edhe disa mungesa të qëllimshme.
- Vendos në mure pesë pyetjet: Kush? Si? Për kë? Çfarë paraqet/mungon? Pse?

Hapat e zbatimit

1. Paraqit mesazhin për 30 sekonda dhe kërko reagimin e parë me një fjalë.
2. Ndaj pjesëmarrësit në pesë grupe. Secili grup nis te një pyetje dhe shënon gjetjet dhe paqartësitë.
3. Pas 5 minutash, grupet kalojnë te pyetja tjetër, lexojnë kontributet dhe shtojnë vetëm elemente të reja.
4. Kur rotacioni përfundon, secili grup merr një pyetje dhe prezanton analizën përfundimtare.
5. Si klasë, krijoni një verdikt të përbashkët: e besueshme; kërkon verifikim; mashtruese; ose e pamjaftueshme për vlerësim.
6. Përsëriteni shkurt me një lloj tjetër përmbajtjeje: reklamë e fshehur, opinion ose video satirike.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cila pyetje prodhoi më shumë informacion të dobishëm?
- Cili element dukej bindës, por nuk ishte provë?
- Çfarë mungonte për të marrë një vendim më të sigurt?
- A mund të jetë mesazhi i saktë, por njëkohësisht i njëanshëm?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Printo mesazhin dhe përdor stacione në mur.
Online	Përdor dhoma të vogla virtuale dhe një tabelë të përbashkët.
Mosha 15-17	Përdor vetëm tri pyetje në raundin e parë: Kush? Çfarë prove? Pse?
Mosha 18-29	Shto pronësinë, modelin e biznesit dhe audiencën e synuar.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos e përdor ushtrimin për të testuar bindjet politike të pjesëmarrësve. Analizo strukturën e mesazhit, jo "kampin" që ai përfaqëson.

MJETI 3 - Lajm, opinion, reklamë, satirë apo propagandë?

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli III, seksioni 3.2	40-55 min	Grupe 3-5	Hyrës

Qëllimi

Të praktikojë dallimin ndërmjet formave të përmbajtjes që shpesh shfaqen në të njëjtën rrjedhë digjitale.

Materialet

- Seti prej 12 kartash të përmbajtjes (Aneksi 3);
- pesë tabela kategorish dhe një kategori shtesë "Nuk ka mjaft informata";
- fletë për arsyetimin e grupit.

Përgatitja e fasilituesit

- Prit kartat dhe përzieji.
- Mos vendos etiketën e saktë në anën e dukshme; mbaj çelësin e fasilituesit veçmas.

Hapat e zbatimit

1. Shpjego shkurt se klasifikimi bëhet sipas funksionit kryesor të përmbajtjes, jo sipas asaj nëse pjesëmarrësi pajtohet me të.
2. Grupet vendosin secilën kartë në kategorinë përkatëse dhe shkruajnë një arsye prej një fjalie.
3. Për tri kartat më të vështira, grupet shënojnë çfarë informacioni shtesë u duhet.
4. Grupet krahasojnë klasifikimet. Kur ka mospajtim, secili argumenton me shenja konkrete nga karta.
5. Fasilituesi zbulon çelësin orientues dhe thekson se disa përmbajtje mund të kenë elemente të përziera.
6. Në fund, secili grup rishkruan një kartë për ta bërë etiketimin e saj më transparent, p.sh. duke shtuar "Opinion", "Reklamë e sponsorizuar" ose burimin.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Pse forma vizuale e lajmit mund të përdoret edhe nga reklama ose propaganda?
- Kur satira mund të kthehet në keqinformim?
- Cili ishte dallimi më i dobishëm ndërmjet lajmit dhe opinionit?
- Pse "nuk ka mjaft informata" është përgjigje e vlefshme?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor karta fizike në dysheme ose mur.
Online	Përdor tabelë drag-and-drop ose formular me zgjedhje.
Mosha 15-17	Përdor gjashtë karta me dallime më të qarta.
Mosha 18-29	Shto përmbajtje native advertising, analizë, advocacy dhe komunikatë institucionale.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Përdor shembuj neutralë dhe të simuluar. Mos paraqit propagandë reale që mund të përforcojë stereotipe ose tensione.

MJETI 4 - I njëjti rast, tri paraqitje

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli III, seksionet 3.1 dhe 4	60-75 min	Grupe 4-6	Mesatar

Qëllimi

Të tregojë se përzgjedhja e burimeve, titullit, renditjes së fakteve dhe tonit krijon korniza të ndryshme të së njëjtës ngjarje.

Materialet

- Paketa e rastit: ndryshim i orarit të transportit publik për nxënësit dhe studentët;
- Versioni A: njoftim komunal; Versioni B: artikull portali; Versioni C: video e shkurtër e një krijuesi përmbajtjeje;
- Tabela e krahasimit: faktet, burimet, toni, çfarë mungon, veprimi që kërkohet.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit tri versione të shkurtra me të njëjtin fakt bazë, por me thekse të ndryshme.
- Sigurohu që asnjë version të mos jetë plotësisht "i keq"; qëllimi është të analizohet përzgjedhja.

Hapat e zbatimit

1. Jep secilit grup vetëm një version. Ata shënojnë çfarë besojnë se ka ndodhur dhe si ndihen pas leximit.
2. Formo grupe të reja ku ka nga një përfaqësues të secilit version. Ata krahasojnë përfundimet fillestare.
3. Grupi plotëson tabelën: cilat fakte janë të përbashkëta, cilat burime përdoren, cilat fjalë ndikojnë tonin dhe çfarë mungon.
4. Grupi vendos nëse dallimet janë të ligjshme editoriale, të njëanshme, mashtruese apo faktikisht të pasakta.
5. Pjesëmarrësit shkruajnë një përmbledhje prej 80-100 fjalësh që ruan faktet kryesore, emërton pasiguritë dhe shmang tonin nxitës.
6. Lexoni dy përmbledhje dhe analizoni çfarë i bën më të balancuara.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- A mund të jenë tri përmbajtjet faktikisht të sakta dhe prapë të krijojnë përshtypje të ndryshme?
- Cili version e drejtoi më shumë emocionin?
- Cila palë ose perspektivë mungonte?
- Si ndikon renditja e informacionit në kuptim?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Printo tri versionet dhe përdor metodën "jigsaë".
Online	Dërgo versionet në dhoma të veçanta dhe përdor dokument të përbashkët.
Mosha 15-17	Mbaji versionet nën 120 fjalë dhe përdor një listë të thjeshtë kontrolli.
Mosha 18-29	Shto komunikatë, deklaratë të opozitës, të dhëna dhe reagim të përdoruesve.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Zgjidh një temë jo-polarizuese. Qëllimi është të kuptohet framing-u, jo të zgjidhet një debat politik real.

MJETI 5 - Laboratori i titullit, fotografisë dhe kontekstit

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli III, seksionet 3.1, 4 dhe 5	55-70 min	Grupe 3-5	Mesatar

Qëllimi

Të demonstrojë si titulli, fotografia, përshkrimi dhe renditja mund ta bëjnë të njëjtin informacion të saktë, sensacional, mashtrues ose etikisht problematik.

Materialet

- Një tekst bazë 180-220 fjalë për hapjen e një programi bursash komunale;
- katër fotografi të simuluara me lidhje të ndryshme me tekstin;
- fleta "Titulli - fotografia - përshkrimi - çfarë mund të keqkuptohet".

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit një tekst me fakte të qarta, një kufizim të rëndësishëm dhe një citat.
- Përgatit fotografi neutrale ose ilustrime pa persona të identifikueshëm.

Hapat e zbatimit

1. Grupet lexojnë tekstin dhe nënvizojnë pesë fakte që titulli nuk duhet t'i shtrembërojë.
2. Secili grup krijon tri tituj: informues, tërheqës por të saktë, dhe clickbait. Titulli clickbait përdoret vetëm për analizë, jo për publikim.
3. Grupet zgjedhin një fotografi dhe shkruajnë përshkrimin e saj, duke shënuar nëse është ilustrim apo pamje nga ngjarja.
4. Grupet shkëmbejnë produktet. Grupi tjetër vlerëson: çfarë premton titulli; çfarë jep teksti; çfarë përshtypjeje krijon fotografia.
5. Secili grup përmirëson versionin dhe shton një shënim korrigjues hipotetik nëse titulli fillestar do të ishte publikuar gabimisht.
6. Klasifikoni elementet si: i saktë; i paqartë; i tepruar; mashtrues; etikisht i papërshtatshëm.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- A mund të jetë titulli teknikisht i vërtetë, por mashtrues?
- Kur fotografia ka nevojë për shënimin "ilustrim"?
- Cili është dallimi ndërmjet tërheqjes së vëmendjes dhe manipulimit?
- Çfarë roli ka korrigjimi publik?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor tekst dhe fotografi të printuara.
Online	Grupet krijojnë një mock-up të thjeshtë në dokument ose prezantim.
Mosha 15-17	Kufizoje në dy tituj dhe dy fotografi.
Mosha 18-29	Shto elementin e SEO-së, njoftimit push dhe përshkrimit për rrjet social.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos përdor fotografi poshtëruese ose të viktimave. Shpjego se fotografia e simuluar nuk duhet të ripërdoret si pamje reale.

MJETI 6 - Redaksia e përgjegjshme

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli III, seksioni 5	75-90 min	Grupe 5-7 + role	Mesatar-avancuar

Qëllimi

Të simulojë vendimmarrjen editoriale kur ka presion kohe, informacion të paplotë, interes publik dhe rrezik të dëmit.

Materialet

- Skenari: një audio e paqartë pretendon se një shkollë do të mbyllet për shkak të një rreziku teknik;
- kartat e roleve: reporter, redaktor, verifikues, përgjegjës për etikë/siguri, menaxher i rrjeteve sociale, përfaqësues i audiencës;
- tri valë informacioni që jepen me intervale;
- formulari i vendimit editorial.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit tri zarfe: pretendimi fillestar; përgjigjja e institucionit; dokumenti teknik dhe korrigjimi i një detaji.
- Cakto një ekspert të ftuar, gazetar ose fact-checker, si vëzhgues opsional.

Hapat e zbatimit

1. Shpjego rolet dhe rregullin: grupi duhet të marrë vendim publikimi pas çdo vale informacioni.
2. Jep valën e parë. Grupet kanë 8 minuta të listojnë faktet, boshllëqet, rreziqet dhe pyetjet për burimet.
3. Grupet vendosin: publiko; publiko me rezervë; prit; ose mos publiko. Dokumentojnë arsyen.
4. Jep valën e dytë, që konfirmon një pjesë por jo të gjithë pretendimin. Grupet rishikojnë titullin dhe vendimin.
5. Jep valën e tretë, ku del konteksti i plotë. Grupet përgatisin versionin final, njoftimin për rrjete sociale dhe, nëse duhet, korrigjimin.
6. Secili grup bën një "konferencë redaksionale" 3-minutëshe dhe mbron vendimin.
7. Eksperti ose fasilituesi jep feedback sipas pesë parimeve etike.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Në cilin moment presioni i shpejtësisë rrezikoi saktësinë?
- Çfarë do të ishte interesi publik dhe çfarë do të ishte vetëm kuriozitet?
- Si ndryshoi vendimi me ardhjen e provave të reja?
- A ishte korrigjimi po aq i dukshëm sa pretendimi fillestar?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor zarfe dhe role të printuara.
Online	Dërgo valët e informacionit me kohë në chat dhe përdor dhoma grupore.
Mosha 15-17	Përdor katër role dhe dy valë informacioni.
Mosha 18-29	Shto çështje të privatësisë, burimit anonim dhe konfliktit të interesit.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Skenari duhet të jetë fiktiv. Mos përdor alarm real, emër shkolle reale ose situatë që mund të shkaktojë panik.



4. Mjetet për Kapitullin IV - Identifikimi dhe reagimi ndaj keqinformimit dhe dezinformimit

Këto mjete ndjekin një progresion nga njohja e shenjave të dyshimit, te verifikimi i burimeve dhe përmbajtjes, vlerësimi i dëmit, reagimi proporcional, korrigjimi dhe parandalimi.

MJETI 7 - Radari i sinjaleve paralajmëruese

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksioni 5.1	35-50 min	Grupe 3-5	Hyrës

Qëllimi

Të zhvillojë një rutinë të shpejtë për të dalluar kur një përmbajtje kërkon ndalim dhe verifikim, pa e shpallur automatikisht të rreme.

Materialet

- Tetë karta postimesh të simuluara;
- kartona jeshile, të verdhë dhe të kuq;
- lista e sinjaleve: urgjencë, burim i paqartë, pretendim absolut, foto pa kontekst, kërkesë për shpërndarje, sulm ndaj grupit, statistikë pa metodologji.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit karta ku disa përmbajtje kanë sinjale të forta, disa të dobëta dhe disa janë të rregullta.
- Shpjego se ngjyra tregon nivelin e kujdesit, jo verdiktin e së vërtetës.

Hapat e zbatimit

1. Lexo kartën e parë. Grupet ngrenë ngjyrën: jeshile = mund të vazhdojmë; verdhë = kontrollo; kuqe = mos shpërnda dhe vlerëso rrezikun.
2. Grupet shënojnë sinjalin konkret që ndikoi vendimin.
3. Për çdo kartë të verdhë ose të kuqe, formulojnë një pyetje verifikimi: “Ku është burimi?”, “Cila është data?”, “Ku është metodologjia?”
4. Krahaso përgjigjet dhe pyet nëse ndonjë grup e ngatërroi emocionin personal me provën.
5. Në raundin e fundit, secili grup krijon një kartë të re që duket bindëse, por përmban dy sinjale paralajmëruese. Grupi tjetër duhet t’i gjejë.
6. Përmbylle me formulën: sinjal → ndalim → pyetje → verifikim.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cili sinjal ju ndikoi më shumë?
- A mund të ketë një lajm të vërtetë me titull të dobët ose emocional?
- Pse “nuk do ta besoni” nuk është provë se përmbajtja është e rreme?
- Cila pyetje verifikimi ishte më e dobishme?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor karta dhe tre zona në dysheme.
Online	Përdor anketë live me tri ngjyra.
Mosha 15-17	Përdor pesë sinjale dhe pesë karta.
Mosha 18-29	Shto koordinimin e llogarive, statistikat dhe pretendimet e ekspertizës.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos u kërko pjesëmarrësve të krijojnë dezinformim bindës për publikim. Kartat e krijuara mbeten brenda sesionit dhe shënohen qartë "Skenar trajnimi".

MJETI 8 - Leximi anësor: dil nga faqja dhe kontrollo burimin

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksioni 6.1 - Verifiko	45-60 min	Çifte ose grupe 3	Mesatar

Qëllimi

Të mësojë pjesëmarrësit të mos mbeten brenda faqes që po vlerësojnë, por të kërkojnë çfarë thonë burime të tjera për autorin, organizatën dhe pretendimin.

Materialet

- Tre faqe ose profile të simuluara me biografi, postime dhe pretendime;
- Fleta e kontrollit të burimit (Aneksi 4);
- internet, ose paketa offline me karta "çfarë thonë burimet e tjera".

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit një burim të besueshëm, një burim të paqartë dhe një burim me konflikt interesi.
- Mos përdor faqe reale të vogla që mund të dëmtohen nga vlerësimi i grupit.

Hapat e zbatimit

1. Pjesëmarrësit shikojnë për 2 minuta faqen e caktuar dhe japin vlerësimin fillestar.
2. Shpjego leximin anësor: hap skeda të reja dhe kërko informacion jashtë faqes.
3. Grupet kontrollojnë: kush e administron; a ka adresë/kontakt; çfarë historie ka; si përshkruhet nga burime të pavarura; a ka korrigjime; a ka interes të deklaruar.
4. Pjesëmarrësit kërkojnë burimin primar të pretendimit dhe krahasojnë formulimin.
5. Plotësojnë fletën: gjetje, prova, çfarë nuk u gjet dhe vlerësimi i ri.
6. Krahasojnë vlerësimin para dhe pas leximit anësor.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cili informacion jashtë faqes e ndryshoi më shumë vlerësimin?
- A është dizajni profesional provë e besueshmërisë?
- Çfarë bëjmë kur nuk gjejmë asgjë për një burim?
- Cili është dallimi ndërmjet paragjykimit ndaj burimit dhe vlerësimit të reputacionit të tij?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Jep dosje me biografinë e faqes, një regjistër publik, dy artikuj dhe një korrigjim.
Online	Përdor kërkim të drejtpërdrejtë në shfletues dhe një dokument të përbashkët.
Mosha 15-17	Kontrollo vetëm tri elemente: kush, burimi primar, çfarë thonë dy burime të tjera.
Mosha 18-29	Shto pronësinë, financimin, konfliktin e interesit dhe historikun e korrigjimeve.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos i nxit pjesëmarrësit të kontaktojnë ose ngacmojnë administratorët e faqeve. Ushtrimi është vlerësim i informacionit, jo hetim personal.

MJETI 9 - Detektivi i kontekstit: fotografi dhe video

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksionet 4, 5.1 dhe 6.1	55-75 min	Grupe 3-4	Mesatar

Qëllimi

Të praktikojë kontrollin e kohës, vendit, burimit dhe përshkrimit të një fotografie ose videoje që mund të jetë reale, por e përdorur jashtë kontekstit.

Rezultatet e të nxënit

- të dallojnë autenticitetin e materialit nga saktësia e përshkrimit;
- të kërkojnë shenja për kohën, vendin dhe burimin origjinal;
- të përdorin kërkimin e kundërt të imazhit kur është i disponueshëm;
- të komunikojnë pasigurinë kur verifikimi nuk është përfundimtar.

Materialet

- Tri paketa me fotografi/video të simuluara: foto e vjetër si "e sotme"; video nga vend tjetër; fotografi reale me përshkrim të shtrembëruar;
- fleta "Kush - Ku - Kur - Çfarë ndodhi para/pas - Burimi origjinal";
- internet opsional dhe projektor.

Përgatitja e fasilituesit

- Përdor materiale pa persona të identifikueshëm ose me licencë të përshtatshme.
- Përgatit të dhëna ndihmëse: tabelë rruge, mot, datë publikimi, version më të gjatë të videos.

Hapat e zbatimit

1. Paraqit materialin pa përshkrim dhe pyet: "Çfarë dimë vetëm nga pamja?" Shkruaj vetëm vëzhgime, jo interpretime.
2. Zbulo përshkrimin viral. Grupet ndajnë çfarë është vëzhgim, çfarë është pretendim dhe çfarë mungon.
3. Grupet analizojnë shenjat: tabela, gjuhë, ndërtesa, mot, hije, uniforma, metadata e disponueshme, data e postimit dhe versioni i plotë.
4. Kur ka internet, bëjnë kërkim të kundërt të imazhit ose kërkim me fjalë kyçe. Kur nuk ka, përdorin kartat ndihmëse.
5. Grupi jep një përfundim: kontekst i konfirmuar; jashtë kontekstit; i pavërtetuar; ose kërkon verifikim ekspert.
6. Shkruajnë një përshkrim të saktë dhe një shënim të shkurtër se si u verifikua.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Pse një fotografi reale mund të prodhojë dezinformim?
- Cili detaj ishte provë dhe cili ishte vetëm hamendësim?
- Kur duhet të ndalemi dhe të kërkojmë ndihmë profesionale?
- Si e shprehim "nuk e dimë ende" pa u dukur të pasigurt?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor paketa me të dhëna ndihmëse të printuara.
Online	Lejo kërkim të kundërt dhe dokumentim të lidhjeve.
Mosha 15-17	Përdor fotografi me shenja të qarta dhe pa tema të ndjeshme.
Mosha 18-29	Shto video të shkurtuara, audio jashtë kontekstit dhe kontroll të kronologjisë.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos përdor pamje të dhunës, viktimave, incidenteve të freskëta ose material që mund të identifikojë personat. Mos ngarko fotografi private në mjete të jashtme.

MJETI 10 - Dosja e verifikimit të një pretendimi

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksionet 3, 4 dhe 6	75-100 min	Ekipe 4-6	Mesatar-avancuar

Qëllimi

Të zhvillojë një proces të plotë fact-checking-u: formulimi i pretendimit, mbledhja e provave, krahasimi i burimeve, verdikti dhe shpjegimi transparent.

Rezultatet e të nxënit

- të ndajnë pretendimin e kontrollueshëm nga opinioni;
- të gjejnë burimin primar dhe së paku dy burime të pavarura;
- të peshojnë cilësinë dhe jo vetëm numrin e burimeve;
- të përdorin verdikte të nuancuara: e vërtetë, e pasaktë, pjesërisht e saktë, e pavërtetuar ose mashtruese.

Materialet

- Pretendimi i simuluar: "Sipas një sondazhi të ri, 82% e të rinjve në komunë duan ndalimin e telefonave në shkollë";
- dosje me postimin, një tabelë të dhënash, metodologji të paplotë, deklaratë të institucionit dhe dy raportime;
- Fleta "Dosja e verifikimit" (Aneksi 5).

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit prova me cilësi të ndryshme dhe një detaj që e bën pretendimin pjesërisht të saktë ose mashtrues.
- Cakto rolet: formulues i pretendimit, kërkues i burimit primar, kontrollues i të dhënave, redaktor i verdiktit, kontrollues i etikës.

Hapat e zbatimit

1. Ekipi shkruan pretendimin në një fjali të kontrollueshme, pa gjuhën emocionale të postimit.
2. Liston çfarë do të duhej të ishte e vërtetë që pretendimi të qëndrojë: kush u anketua, sa persona, kur, si u formulua pyetja.
3. Ekipi rendit provat sipas peshës: burim primar, të dhëna zyrtare, ekspertizë, raportim i pavarur, postim i përsëritur.
4. Kontrollon numrat, përqindjet, bazën e krahasimit dhe kontekstin.
5. Plotëson tabelën "prova që mbështet / prova që kundërshton / çfarë nuk dimë".

6. Zgjedh verdiktin dhe shkruan arsyetimin në 120-160 fjalë, duke nisur me faktin e verifikuar.
7. Një ekip tjetër bën kontrollin e cilësisë: a përputhet verdikti me provat; a ka teprim; a janë burimet të pavarura; a është e qartë pasiguria?
8. Ekipi finalizon kartelën e verifikimit dhe listën e burimeve.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cila provë kishte më shumë peshë dhe pse?
- A e ndryshoi metodologjia kuptimin e përqindjes?
- Pse një pretendim mund të jetë "pjesërisht i saktë" ose "mashtrues"?
- Çfarë do të bënit nëse burimi primar nuk përgjigjet?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Jep të gjitha dokumentet në një zarf të strukturuar.
Online	Lejo kërkim të kontrolluar dhe ruajtje të lidhjeve në dokument.
Mosha 15-17	Përdor një pretendim të thjeshtë me tri burime.
Mosha 18-29	Shto të dhëna statistikore, burim anonim dhe konflikt interesi.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Pretendimi duhet të jetë fiktiv ose i vjetër dhe i mbyllur. Mos i dërgo pjesëmarrësit të kontaktojnë persona realë gjatë sesionit.

MJETI 11 - Ekipi i reagimit: Ndalo - Ruaje - Verifiko - Vlerëso - Reago - Mëso

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksioni 6.1	70-90 min	Ekipe 5-7	Mesatar

Qëllimi

Të praktikojë jo vetëm verifikimin, por edhe vlerësimin e dëmit dhe zgjedhjen e reagimit proporcional.

Rezultatet e të nxënit

- » të zbatojnë gjashtë hapat e modelit të manualit;
- » të dallojnë gabimin me ndikim të ulët nga përmbajtja me rrezik të lartë;
- » të zgjedhin mes mosndërveprimit, korrigjimit privat, korrigjimit publik, raportimit, fact-checker-it dhe institucionit;
- » të dokumentojnë prova pa e amplifikuar përmbajtjen.

Materialet

- » Skenari: video e vjetër po paraqitet si incident i sotëm dhe komentet po tensionojnë dy grupe të të rinjve;
- » kartat e roleve: verifikim, komunikim, siguri/raportim, organizatë rinore, media, mësimdhënës/mentor;
- » Matrica e dëmit dhe reagimit (Aneksi 6).

Përgatitja e fasilituesit

- » Përgatit një screenshot të anonimizuar dhe një version të plotë të videos.
- » Cakto kufij të qartë: nuk ripostohet materiali dhe nuk riprodhohen komentet fyese.

Hapat e zbatimit

1. Ndalo: grupi përshkruan çfarë nuk duhet bërë në 10 minutat e para.
2. Ruaje: vendos çfarë prove duhet dokumentuar, nga kush dhe ku do të ruhet në mënyrë të sigurt.
3. Verifiko: formulon pretendimin, kërkon burimin origjinal, datën, vendin dhe raportimet e pavarura.
4. Vlerëso: përdor matricën e dëmit - shtrirja, cenueshmëria e personave, rreziku i panikut, diskriminimit ose dhunës.
5. Reago: zgjedh nivelin e reagimit dhe shkruan një plan: kush bën çfarë, në cilin kanal dhe brenda cilit afat.
6. Mëso: identifikon taktikën manipuluese dhe përgatit një këshillë parandaluese për herën tjetër.
7. Ekipet prezantojnë planin në 4 minuta. Paneli i pjesëmarrësve vlerëson: a është i sigurt, proporcional, i bazuar në prova dhe i zbatueshëm?

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- A ishte verifikimi i mjaftueshëm për të vendosur reagimin?
- Kur mosndërveprimi është veprim i përgjegjshëm?
- Si ruhet dëshmia pa e shpërndarë më tej?
- Cili aktor duhet njoftuar kur rreziku tejkalon kapacitetin e grupit?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor skenar të printuar, role dhe matricë në mur.
Online	Përdor dhoma grupore dhe formular të përbashkët.
Mosha 15-17	Kufizo rolet dhe përdor vetëm tre nivele reagimi.
Mosha 18-29	Shto komunikimin me media, institucion, platformë dhe fact-checker.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Kur skenari prek tensione ndërmjet komuniteteve, përdor emra neutralë dhe mos riprodho etiketime. Në rast real, fasilituesi duhet të ndalojë simulimin dhe të ndjekë protokollet përkatëse.

MJETI 12 - Korrigjo pa e amplifikuar

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksioni 6.2	45-60 min	Çifte + plenare	Mesatar

Qëllimi

Të praktikojë formulimin e korrigjimeve që fillojnë me faktin, japin shpjegim dhe burim, pa përsëritur tepër pretendimin e rremë ose turpëruar personin.

Rezultatet e të nxënit

- » të përdorin strukturën "Fakti - Çfarë ndodhi - Prova - Veprimi";
- » të shmangin titullin që amplifikon pretendimin e rremë;
- » të dallojnë korrigjimin privat nga ai publik;
- » të shkruajnë në ton jo-konfliktual dhe të bazuar në prova.

Materialet

- » Katër shembuj korrigjimesh të dobëta;
- » Fleta "Korrigjimi fact-first" (Aneksi 7);
- » një pretendim i verifikuar si foto e vjetër e paraqitur si aktuale.

Përgatitja e fasilituesit

- » Përgatit shembuj me gabime: përsëritje e rrenës në titull, tallje, mungesë burimi, gjuhë absolute.
- » Shpjego se "fact-first" nuk do të thotë fshehje e pretendimit, por vendosje e faktit në qendër.

Hapat e zbatimit

1. Çiftet analizojnë korrigjimet e dobëta dhe shënojnë çfarë mund të rrisë konfliktin ose dukshmërinë e rrenës.
2. Paraqit formulën: (1) fakti i saktë; (2) çfarë ishte problematike; (3) si u verifikua; (4) çfarë duhet bërë.
3. Çiftet shkruajnë një mesazh privat, një koment publik dhe një postim të shkurtër institucional për të njëjtin rast.
4. Çiftet shkëmbejnë mesazhet dhe vlerësojnë: saktësi, qartësi, ton, burim, rrezik amplifikimi.
5. Rishkruajnë titullin që të përmbajë faktin dhe jo pretendimin e rremë.
6. Krahasoni kur është më mirë të korrigjohet privatisht dhe kur interesi publik kërkon korrigjim publik.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cili formulim uli më shumë tensionin?
- Sa detaje të pretendimit të rremë duhen për ta kuptuar korrigjimin?
- Pse tallja mund ta bëjë personin më rezistent ndaj faktit?
- Si bëhet burimi i verifikimit i lehtë për t'u kontrolluar?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdor fletë me korrigjime dhe lapsa për redaktim.
Online	Përdor komente në dokument dhe një simulim të postimit.
Mosha 15-17	Përdor formulë me tri fjali.
Mosha 18-29	Shto pyetjen kur duhet korrigjim, sqarim, përditësim ose tërheqje.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos postoni realisht korrigjimet gjatë trajnimit. Shembujt duhet të jenë të shënuar "ushtrim".

MJETI 13 - Parandalimi i manipulimit: laboratori i prebunking-ut

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, seksioni 3 - Parandalimi i dezinformimit	60-75 min	Grupe 4-5	Mesatar-avancuar

Qëllimi

Të mësojë pjesëmarrësit të njohin taktikat manipuluese para se të hasin një pretendim konkret dhe të krijojnë paralajmërime të shkurtra edukative.

Rezultatet e të nxënit

- » të njohin taktika si urgjenca emocionale, dilema e rreme, imitimi i autoritetit, komploti pa prova dhe nxjerrja jashtë kontekstit;
- » të dallojnë taktikën nga tema ose bindja;
- » të prodhojnë një mesazh prebunking-u me shembull të padëmshëm;
- » të testojnë nëse mesazhi është i kuptueshëm dhe jo patronizues.

Materialet

- » Pesë karta taktikash;
- » shembuj neutralë të simuluar;
- » Canvas-i i prebunking-ut (Aneksi 8): taktika, sinjali, shembulli, pyetja mbrojtëse, veprimi.

Përgatitja e fasilituesit

- » Zgjidh taktika të përgjithshme që mund të shfaqen në shumë tema.
- » Mos përdor shembuj që përsërisin teori konspirative reale në detaje.

Hapat e zbatimit

1. Fasilituesi demonstron një taktikë me shembull neutral: “Shpërndaje tani para se ta fshijnë”.
2. Grupet marrin nga një kartë dhe identifikojnë: çfarë emocioni shfrytëzon, çfarë mendimi të shpejtë kërkon dhe çfarë pyetjeje e ngadalëson.
3. Grupi krijon një mesazh prebunking-u prej 40-60 fjalësh: emërton taktikën, jep shembull të thjeshtë dhe ofron një veprim.
4. Grupet e testojnë mesazhin me një grup tjetër, i cili duhet ta shpjegojë taktikën me fjalët e veta.
5. Mesazhi rishkruhet për të qenë më i qartë, më i shkurtër dhe pa e përsëritur materialin e dëmshëm.
6. Në fund, grupet krijojnë një seri prej tri kartash ose një video-skenar 30-sekondësh me thirrjen: “Ndalo - emërto taktikën - kërko provën”.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cila taktikë ishte më e vështirë për t'u shpjeguar?
- Si shmanget toni që i trajton njerëzit si naivë?
- A mund të përdoret e njëjta taktikë nga aktorë të ndryshëm?
- Si matet nëse prebunking-u funksionoi?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Krijo karta ose posterë në letër.
Online	Krijo carousel të simuluar ose storyboard videoje.
Mosha 15-17	Përdor tri taktika dhe shembuj nga reklamat ose thashethemet.
Mosha 18-29	Shto imitimin e ekspertit, polarizimin dhe përdorimin selektiv të statistikave.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos krijo materiale manipuluese realiste që mund të dalin jashtë kontekstit. Çdo produkt duhet të ketë shënimin e dukshëm "Material edukativ - shembull i simuluar".

MJETI 14 - Përmbajtja me IA: nga dyshimi te verifikimi

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli IV, format e përmbajtjes dhe skenari i AI-së	60-80 min	Grupe 3-5	Mesatar-avancuar

Qëllimi

Të zhvillojë një qasje të kujdesshme ndaj imazheve, audios dhe videove të mundshme të gjeneruara ose manipuluara me AI, pa u mbështetur vetëm te "duket e çuditshme".

Rezultatet e të nxënit

- të dallojnë sinjalet vizuale nga provat e verifikimit;
- të kërkojnë burimin origjinal, kontekstin dhe raportimet e pavarura;
- të përdorin gjuhë të saktë kur autenticiteti nuk mund të konfirmohet;
- të vlerësojnë rrezikun e privatësisë, imitimit dhe dëmit.

Materialet

- Katër materiale të simuluara: një imazh real, një imazh i gjeneruar, një imazh i modifikuar dhe një material i pavërtetuar;
- lista e kontrollit: origjina, versionet më të hershme, konsistenca, metadata/provenanca, burimi zyrtar, konfirmimi i pavarur;
- Fleta "Niveli i sigurisë së përfundimit".

Përgatitja e fasilituesit

- Përdor imazhe neutrale, pa persona realë ose të mitur.
- Shpjego se detajet si duart, hijet ose teksti i çuditshëm janë sinjale të mundshme, jo prova të mjaftueshme.

Hapat e zbatimit

1. Grupet japin vlerësimin fillestar dhe shënojnë nivelin e sigurisë nga 1 në 5.
2. Ndajnë sinjalet vizuale nga pyetjet e verifikimit.
3. Kërkojnë origjinën: postimi më i hershëm, autori, deklarimi se është AI, versionet e tjera dhe burimi i ngjarjes.
4. Krahasojnë me burime zyrtare ose të pavarura dhe kontrollojnë nëse ekziston material tjetër nga e njëjta skenë.
5. Zgjedhin formulimin: "e konfirmuar", "e manipuluar", "e gjeneruar", "nuk ka prova të mjaftueshme" ose "autenticiteti nuk mund të verifikohet".

6. Shkruajnë një kështillë publike që shmang alarmizmin dhe nuk e ripublikon materialin.
7. Diskutojnë rastet kur duhet raportim, ruajtje prove dhe kërkim ndihme profesionale.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Pse intuita vizuale nuk mjafton?
- Cili është rreziku i etiketimit të gabuar të një fotografie reale si AI?
- Si komunikohet pasiguria pa e minuar besimin?
- Kur çështja kalon nga verifikimi te privatësia dhe siguria?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Jep dosje me versionet e materialit dhe burimet ndihmëse.
Online	Përdor kërkim të kontrolluar dhe mjete verifikimi vetëm me materiale jo-private.
Mosha 15-17	Përdor imazhe objektesh dhe peizazhesh, jo fytyra.
Mosha 18-29	Shto audio të sintetizuar, provenance/content credentials dhe dilema etike.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos kërko krijimin e deepfake-ve, materialeve intime ose imitimin e personave realë. Mos ngarko fotografi private të pjesëmarrësve në mjete të AI-së.



5. Mjete për Kapitullin V - Bullizmi Kibernetik

Këto mjete ndjekin rrjeedhën e informacionit të kapitullit V dhe synojnë t'i vijnë në ndihmë facilituesve për të mësuar të rinjtë se si të identifikojnë në mënyrë të lehtë bullizmin kibernetik, çfarë impakti ka ky lloj bullizmi, si të reagojnë ndaj tij apo të ndihmojnë miqtë që janë viktimë e bullizmit kibernetik, dhe se si të ndërmarrin hapa konkretë për ta ndaluar apo raportuar atë.

MJETI 15 - Personazhe të njohur dhe bullizmi kibernetik

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi kibernetik, seksioni 4	60 min	Grupe 15-20 persona	Bazike- Mesatare

Qëllimi

Identifikimi dhe kuptimi i bullizmit kibernetik.

Rezultatet e të nxënit

- Identifikimi i bullizmit kibernetik nëpërmjet situatave dhe shembujve audio-vizivë;
- Reflektim lidhur me situatat dhe personazhet e diskutuara mbi arsyet që i bëjnë ata bullizues dhe se si janë trajtuar këto personazhe në filma apo në shoqëri;
- Reflektim mbi rrethanat ku ndodh bullizmi kibernetik, dhe formimi i një përkufizimi nga të rinjtë vetë me fjalë të thjeshta, të përshtatshme me kontekstin e tyre.

Materialet

- Kompjuter dhe akses në internet për të kërkuar personazhet. Paketë Microsoft Office për të përdorur Microsoft word në ruatjen e gjetjeve nga kërkimi online.
- Letra dhe printer në rast se kërikimi do të bëhet paraprakisht dhe do t'i jepet të rinjve nga faciliuesi.
- Tabelë e zezë/e bardhë/smart board për pemën e mendimeve dhe fjalëve.

Përgatitja e fasilituesit

- Familjarizohuni me përmbajtjen e manualit dhe përkufizimin e manualit mbi bullizmin kibernetik.
- Bëni një kërkim paraprak mbi personazhet dhe influencerët, për të mos ia lënë rastësisë kërkimin me klasën/të rinjtë. Mbani parasysh disa personazhe që mund t'i merrni si shembull.
- Shmangni bisedat që kanalizohen në një situatë konkrete apo vënë në qendër të vëmendjes një të ri/të re.

Hapat e të nxënit

Përdorni një kompjuter për të hapur një faqe kërkimi si google search, bing apo duck duck go. Pasi të hapni faqen, kërkoni shembuj të "karaktereve në filma" apo "influencer" bullizues. Mbasi keni bërë një kërkim fillestar, mblidhni imazhe dhe emra të këtyre personazheve/personave dhe vendosini në një dokument nga ku mund të analizoni bashkë me klasën tiparet bullizuese, cfarë ata/ato përfaqësojnë, dhe nëse dikush do të ndajë eksperiënca personale të ngjajshme.

Më pas mundohuni të përkufizoni fenomenin e bullizmit online dhe krijoni një pemë mendimesh me termat kyç që lidhen me këtë fjalë dhe fenomen. Analizoni cilat janë fjalët kryesore që lidhen me të dhe mendoni si mund të formuloni një përkufizim mbi bullizmin kibernetik.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Çfarë është për ju një person bullizues?
- A jeni hasur me persona të tillë në jetën e përditshme, apo keni bërë veprime ju vetë si një person bullizues?
- Çfarë është bullizmi kibernetik sipas jush?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Jep dosje me versionet e materialit dhe burimet ndihmëse që i keni kërkuar më parë online.
Online	Përdor kërkim të kontrolluar.
Mosha 15-17	Përdor personazhe të njohur për grupmoshën.
Mosha 18-29	Fokusohuni në kërkimin e influencerëve bullizues apo rasteve ku këta janë përfshirë.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos merrni fjalë për fjalë rastet ku personazhet e filmave apo influencerat janë përfshirë në raste bullizimi. Mundohuni t'i perifrazoni situatat. Po ashtu kujdesuni të kërkoni më parë fotot online për të shmangur foto apo skena sensitive, të dhunshme apo delikate për të rinjtë.

MJETI 16 - Pyetsor dhe skenarë mbi bullizmin kibernetik

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi kibernetik, seksioni 4	40 min	Grupe 30-40 persona	Bazike- Mesatare

Qëllimi

Identifikimi dhe kuptimi i bullizmit kibernetik.

Rezultatet e të nxënit

- Mbledhja e të dhënave mbi njohuritë lidhur me bullizmin kibernetik dhe lehtësimin e mbushjes së boshllëqeve në informacion.
- Identifikimi i bullizmit kibernetik sipas situatave të ndryshme.

Materialet

- Kopjuter dhe akses në internet për hartimin e pyetsorit si edhe për grupin e targetuar për përgjigjet.
- Letër dhe printer për të printuar skenarët e ndryshëm të diskutimit.

Përgatitja e fasilituesit

- Familjarizohuni me përmbajtjen e manualit dhe përkufizimin e manualit mbi bullizmin kibernetik.
- Kërkoni një mendim të dytë mbi pyetjet për të garantuar që janë të përgjithshme pa cënuar identifikimin e personave që përgjigjen.
- Merrni leje nga drejtuesit e shkollës apo kolegët në organizatë për shpërndarjen e pyëtsorit dhe sigurohuni që të dhënat e mbledhura procedohen dhe menaxhohen sipas rregullave për mbrojtjen e të dhënave të institutcionit.

Hapat e të nxënit

Ndërto një pyetsor online në bazë të infromacionit dhe pyetjeve reflektuese të Manualit. Ky pyetsor duhet të synojë të identifikojë se sa njohuri kanë të rinjtë apo edhe stafi i shkollës/organizatës ku punon. Në rast të dy target grupeve të ndryshme, duhen pyetsorë të personalizuar për scilin grup. Sigurohuni që pyëtsori të jetë anonim.

Pas ndërtimit të pyëtsorit dhe analizës së përgjithshme të përgjigjeve. Ndërtoni skenarë, ose përdorni skenarët e vendosur në manual për të nxitur diskutime mbi boshllëqet në njohuri të të rinjve apo kolegëve. Më pas organizoni grupe diskutimi ku të rintjë apo kolegët diskutojnë nëse në këto skenarë kemi të bëjmë me bullizëm kibernetik apo jo.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- A keni qeshur ose pëlqyer ndonjëherë një postim që tallte dikë? Çfarë thotë ai reagim rreth rolit tuaj në atë situatë?
- A keni përjashtuar ndonjëherë me qëllim dikë nga një chat grupi ose hapësirë online? Si do të ndiheshit nëse do të ishit në anën e atij/asaj që është përjashtuar?
- Nëse diçka online ju ka bërë të ndiheni nervoz, të turpëruar ose të frikësuar të flisni, a i keni treguar dikujt? Çfarë ju pengoi, ose çfarë ju ndihmoi?
- A ka shkolla juaj një protokoll të qartë dhe të dukshëm për raportimin e bullizmit kibernetik që nxënësit e dinë dhe i besojnë? Kur e diskutuat herën e fundit me klasën tuaj?
- Mendoni për një nxënës që mund të përjetojë bullizëm online tani, pa i treguar askujt. Cilat sinjale mund të humbisni?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Online	Siguohuni që ka akses në pyetsor dhe linku është i sigurt dhe i zhvilluar në platformat që shkolla/organizata përdor.
Mosha 15-17	Përdor pyetje të thjeshta dhe pyetsor më të shkurtër.
Mosha 18-29	Fokusohuni në pyetje në eksperienca të përditshmërisë dhe në format e identifikimit dhe reagimit të të rinjve.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

- Mos ndani informacione specifike nga përgjigjet e pyëtsorit të cilat mund të identifikojnë personin që e ka plotesuar.
- Perifrazoni dhe përmblidhni përgjigjet për t'i përdorur si shembuj në diskutim.
- Kujdesuni që pyetjet të mos lejojnë identifikimin, apo të jenë mjaft personale.
- Garantoni përpupinimin dhe menaxhimin e të dhënve sipas rregullave për të dhënat personale sipas shkollës/organizatës.

MJETI 17 - Bullizëm kibernetik apo justifikime

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi kibernetik, seksioni 4.1 dhe 4.2	30 min	Grupe 20-30 persona	Mesatar

Qëllimi

Kuptimi i kontekstit pse ndodh bullizmi kibernetik dhe identifikimi i sjelljeve personale te gabuara.

Rezultatet e të nxënit

- Nxitja e mendimit kritik mbi situatat potenciale të përditshmërisë që janë bullizëm kibernetik.
- Nxitja e reflektimit vetjak mbi identifikimin apo ndarjen e situatave të shakase/justifikimit apo bullizmit kibernetik.

Materialet

Materialet e nevojshme janë një tabelë për të shënuar justifikimet, ose tablet për grupe të ndryshme nëse aktiviteti bëhet në grupe më të vogla.

Përgatitja e fasilituesit

Mundohuni të orientoni të rinjtë sipas situatave të përditshmërisë për t'i sjellë justifikimet sa më afër realitetit, por duke u kujdesur që të mos i referohen rasteve konkrete të ndodhura në shkollë.

Hapat e të nxënit

Bëni një diskutim me të rintjë se cfarë justifikimesh mund të përdorin njerëzit/të rinjtë për të justifikuar sjelljet e tyre bullizuese. Mund të listoni këto sjellje si shembuj potencialë, por lejoni së pari që vetë të rinjtë/studentët të sjellin shembuj dhe t'i përshkruajnë ato.

Shembujt:

- Ngacmim mes shokësh
- Shaka
- Tallje
- Vënia e fajit dikujt tjetër apo situatës që ndodhi gjatë bullizmit
- Vënia e fajit kontekstit që lehtësoi që të ndodhte bullizmi
- Stereotipet e ndryshme
- Justifikimi se personi që u bullizua ka bullizuar dikë tjetër apo atë vetë më parë, ndaj e meriton.

Më pas pyesni të rinjtë apo nxënësit nëse kanë parë dikë të përdorë këto justifikime më parë. Si janë ndjerë kur i kanë dëgjuar këto justifikime. Mund të lejoni që të rinjtë t'i bëjnë këto biseda në grupe dy nga dy dhe më pas të ndajnë reflektime me të gjithë grupin.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Mendoni për javën e kaluar online. A keni postuar, ndarë ose komentuar diçka rreth dikujt tjetër – edhe si shaka? Keni parë dikë të përdorë këto justifikime më parë?
- A keni qeshur ose pëlqyer ndonjëherë një postim që tallte dikë duke u justifikuar sipas një prej shembujve të mësipërm?
- Para postimit ose mesazhit tuaj tjetër, pyesni veten: a po përdor një justifikim pë diçka që mund të jetë bullizim kibernetik?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Shkruani në tabelë sugjerimet e të rinjve dhe më pas moderoni diskutimin duke ndarë të rinjtë në grupe me nga dy persona.
Online	Përdor tabletë dhe ndaj të rinjtë në grupe të vogla diskutimi mbi arsyet dhe më pas diskutimin rreth tyre.
Mosha 15-17	Jep 3-4 shembuj paraprakisht për të orientuar bisedën. Diskutoni në grup të madh në vend të diskutimeve dy e nga dy.
Mosha 18-29	Nxisni diskutimin dhe argumentimin e situatave dhe justifikimeve përveç listimit të tyre nga të rinjtë.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

- Kujdes për të mos kaluar në diskutime të situatave konkrete në shkollë të bullizmit kibernetik.
- Moderoni diskutimin mes të rinjve që të mos kalohet në akuza apo polarizim opinionesh, por diskutimi të mbetet konstruktiv.

MJETI 18 - Ku qëndron ti në një situatë bullizmi kibernetik

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi kibernetik, seksioni 4	60 min	Grupe 15-20 persona	Mesatare - e avancuar

Qëllimi

Reflektim në grup mbi bullizmin kibernetik dhe reagimin ndaj tij.

Rezultatet e të nxënit

- Diskutim dhe reflektim në grup mbi situata që qëndrojnë në kufi të shakasë dhe bullizmit kibernetik.
- Nxitja e diskutimit se ku qëndron kufiri duke kërkuar pozicionimin e të rinjve dhe argumentimin e opinionit të tyre.
- Kuptimi mes të rinjve se situatat e shakasë mundet të kalojnë shpejt në bullizim dhe se persona të ndryshëm kanë ndjeshmëri emocionale të ndryshme.

Materialet

Katër fleta A4 të printuara ku shënohen pozicionet për t'u vendosur në cepat e klasës.

Përgatitja e fasilituesit

- Moderoni diskutimin për të mos patur akuza personale ose nxitje të qëndrimeve polarizuese.
- Nxisni mendimin kritik pas pozicionimit të studentëve që të ketë debat të argumentuar.
- Synoni të shpjegoni se pas qëndrimeve të të rinjve janë toleranca të ndryshme ndaj një shakaje e cila përkthehet si një kufi i ndryshueshëm impakti emocional që shakaja mund të ketë nga një i ri tek tjetri.
- Shpjegoni se si shakaja për dikë mund të jetë bullizëm kibernetik, apo kur shakaja si justifikim në fakt është bullizim kibernetik.

Hapat e të nxënit

Ndani klasën në katër pjesë. Në secilën prej pjesëve vendosni një nga këto fjalë: "Dakord"; "Shumë dakord"; "Kundërshtoj"; "Nuk kam një mendim".

Lexoni fjalinë e mëposhtme në grup dhe kërkojini të rinjve të pozicionohen sipas bindjeve të tyre. Pasi të rinjtë të pozicionohen në klasë sipas fjalëve/bindjeve, kërkojini disa prej tyresh të argumentojnë qëndrimet e tyre. Më pas nxisni një bisedë apo diskutim mbi bazën e argumentave të marra.

Fjalia: "Jo cdo gjë është bullizëm kibernetik. Disa raste janë edhe shaka, se ne jemi të rinj."

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cfarë do të thotë ky pozicionim/opnion për ju?
- Përse e keni këtë opinion?
- A mund të përshkallëzohet një shaka në bullizëm kibernetik? Kur?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Vendosni fletët e printuara në 4 pjesë të ndryshme të klasës dhe kërkojuni të rinjve të pozicionohen sipas opinioneve.
Online	Mund të përdorni platforma online për ta kthyer pozicionimin me votim me emoji ku secili emoji/ikonë i përket një opinion. Pasi të mblidhni votat mund të nisni diskutimin.
Mosha 15-17	Mund të mbani vetëm 3 nga 4 opinionet për ta lehtësuar pozicionimin.

MJETI 19 - Fjalitë e keqkuptuara

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi kibernetik, seksioni 4.1 dhe 4.2	30 min	Grupe 15-20 persona	Mesatare

Qëllimi

Reflektim personal mby bullizmin kibernetik.

Rezultatet e të nxënit

- Nxitje e reflektimit personal mbi bullizmin kibernetik nëpërmjet fjalive përshkrueses.
- Nxitje e eksplorimit të gjëndjes emocionale nga situata të bullizmit kibernetik.
- Mendim kritik mbi bullizmin kibernetik dhe pasojat që lidhen me të.

Materialet

Letër, printer dhe gërshërë për të përgatitur fjalitë që do t'u ndahen grupeve.

Përgatitja e fasilituesit

- Printoni dhe lexoni fjalitë për të rinjtë në rast se ka pyetje apo paqartësi mbi termat.
- Shpjegoni se nuk ka përgjigje të drejtë apo të gabuar dhe se synimi është mendimi kritik.

Hapat e të nxënit

Ndajeni grupin në dy nëngrupe. Secilit prej grupeve jepini një set prej 5 fjalish.

Kërkojuni t'i rendisin ato sipas impaktit negativ (cila nga fjalitë e thëna ka impakt më të madh negative tek dikush). Jepuni 10 minuta kohë për t'i lexuar edhe për t'i renditur.

Më pas kërkojini secilit grup të japë fjalinë me impaktin më të madh negativ grupit tjetër. Kërkojini grupeve të rendisin sërish fjalitë tani që kanë një fjali të re nga grupi tjetër.

Në fund mblidhni të rinjtë të prezantojnë renditjen e fjalive sipas grupeve dhe për një diskutim të përgjithshëm. Kërkojini të rinjve t'i lexojnë fjalitë me zë të lartë.

Seti 1 (për grupin A)

- "Sërish ke postuar një foto, si mendon që dikush do t'i bëjë 'like' kësaj?"
- "Ki kujdes çfarë shkruan në grup, sepse tani e tutje çdo mesazh yti do të bëhet screenshot dhe do të qarkullojë."
- "Krijuam një grup të ri pa ty, kështu flasim lirshëm pa u shqetësuar që do ta lexosh."
- "Të gjithë e kanë parë tashmë foton/video-n tënde, s'ke pse të fshihesh më, është kudo online."
- "Vazhdo të postosh sikur asgjë s'ka ndodhur, po të gjithë dinë çfarë thonë për ty pas shpine në grupet e tjera."

Seti 2 (për grupin B)

- » "Përsëri ke shkruar gabim në koment, screenshot-i tashmë qarkullon nëpër grupe, të gjithë po qeshin."
- » "Kjo foto jote është bërë meme tashmë, e ka parë tërë shkolla nëpër story-t e ndryshme."
- » "S'ke ndjekës të vërtetë online, të gjithë vetëm të ndjekin sepse s'duan të duken keq, jo se t'i pëlqen dikush."
- » "Krijuam një llogari të re vetëm për të postuar gjëra për ty, kështu s'do ta dish kurrë kush jemi vërtet."
- » "Vazhdo të postosh dhe fshiji llogaritë sa të duash, ne gjithmonë do të gjejmë mënyrë tjetër për t'i sjellë ato mbrapsht."

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- » A ishte e lehtë të renditësh fjalitë sipas dëmit të shkaktuar?
- » Si ju bëjnë ato fjali të ndiheni?
- » Cfarë impakti emocional dhe psikologjik mund të kenë ato fjali në një viktimë të bullizmit kibernetik?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Printoni fjalitë që t'i keni në dispozicion për të rinjtë dhe grupet e formuara.
Online	Mund të zgjidhni ta bëni aktivitetin në tablet/Ipad pa i printuar fjalitë.
Mosha 15-17	Mund të thjeshtoni fjalitë për këtë audiencë me moshë më të vogël, ose të riprodhoni fjali të tjera në të njëjtën linjë si fjalitë e ushtrimit.
Mosha 18-29	Nëse niveli i audiencës me njohuri mbi temën është mbi mesatar mund të shtoni numrin e fjalive në renditje nga 8-10 fjali.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Nëse cilësoni se ndonjë nga fjalitë prek një situatë aktuale apo të afërt bullizmi, mund ta zëvendësoni atë fjali me një fjali tjetër më të përgjithshme.

MJETI 20 - Teatër pjesëmarrës në situatë bullizmi kibernetik

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi kibernetik, seksioni 5	80 min	Grupe 20-20 persona	Mesatare- e avancuar

Qëllimi

Nxitja e reflektimit dhe ndalimit në raste të identifikimit të bullizmit kibernetik.

Rezultatet e të nxënit

- Nxitja e reflektimit mbi situata konkrete të bullizmit kibernetik.
- Nxitja e një roli aktiv në ndalimin e bullizmit kibernetik.

Materialet

Fletë dhe printer për të printuar skenarin në disa kopje.

Përgatitja e fasilituesit

- Sigurohuni që grupi ndihet mirë me formën e aktivitetit.
- Sigurohuni që rolet të mos ndahen apo performohen nga të rinj të cilët kanë qënë apo janë viktimë e bullizmit kibernetik, qe mund t'i vendosë ata në një situatë të vështirë emocionale (sipas dijenisë suaj).

Hapat e të nxënit

Bazuar në skenarin e mëposhtëm ndani rolet me studentët/të rinjtë/kolegët. Më pas pjesa tjetër e grupit shërben si audiencë. Jepini kohë rreth 5-6 minuta aktorëve të rinj të familjarizohen me tekstin dhe më pas lejojini të përformojnë dialogun përpara grupit të audiencës. Bëjeni këtë një herë. Lejoni rreth 5 -6 minuta reflektim.

Përsëriteni tekstin sipas ndarjes së roleve dhe sapo të vijë momenti kulminant i reagimit apo pasojës për viktimën ndaloni performancën. Drejtohuni audiencës së të rinjve/kolegëve dhe pyetini se cfarë do të bënin ata ndryshe në këtë situatë. Cfarë do të ndryshonin nga sjellja e viktimës apo bullizuesit/bullizueses. Si do ta përundonin ata ndryshe skenarin?

Skenari ndërtohet me qëllim që të ndalet pikërisht në momentin kulmor, para pasojës emocionale për viktimën.

Fasilituesi: lexon hyrjen edhe pjesët në kllapa apo përshkrimet.

Arta	Drini	Dea	Blendi	Fjolla
nxënësja që bëhet objekt i bullizmit	nxënësi që e fillon dhe e drejton bullizmin	shoqja e Drini, pjesëmarrëse aktive (qesh, shton komente)	bashkënxënës që sheh gjithçka në grup por hesht (dëshmitar pasiv)	**(opsionale, nëse grupi është më i madh)** bashkënxënëse që shfaq shqetësim të vogël por nuk ndërhyn.

FASILITUESI: Ky skenar përshkruan një situatë të bullizmit kibernetik brenda një grupi klase në Viber/WhatsApp, ku një nxënëse përjashtohet dhe përqeshet gradualisht nga bashkëmoshatarët e saj.

DRINI: *(duke shkruar në grup)* Ej, e pa dikush si u përgjigj Arta sot në orën e matematikës? 😂 Foli sikur s'e di as tabelën e shumëzimit.

DEA: Hahaha po e pashë! Ish shumë e vështirë me e mbajt të qeshurit.

BLENDI: *(hesht, vetëm lexon mesazhet, s'shkruan asgjë)*

DRINI: I shkruan veçmas Deas: Le ta bëjmë një grup vetëm për ne, pa e futë Artën. Kështu flasim lirshëm.

DEA: Haha mirë, e krijoj tani grupin "9-B pa Arta" 😂

*(Aktorët që luajnë **DRINI** dhe **Dean** mund të "krijojnë" grupin duke bërë gjestin e shtypjes në telefon)*

DRINI: *(në grupin e ri)* Sa here e shof si vishet edhe më shumë më vjen me qesh. Dje pat një bluzë sikur e ka marrë nga motra e vet 10 vjeç më e vogël.

DEA: 😂😂😂 Po posto ndonjë foto të saj nga ditëlindja e kaluar, e kemi te grupi i vjetër.

*(**Drini** "poston" një foto fiktive të **Artës** të gjeneruar me IA, e cila duket sikur qesh me të, dhe shton titra)*

DRINI: *(duke shkruar titrën nën foto)* "Kur mendon se je e bukur por s'je"😂

BLENDI: *(pas heshtjes së gjatë, shkruan diçka të shkurtër)* Hajt more, mos e teproni.

DEA: Hajt Blendi mos u bo i mirë tash, edhe ti ke qesh me te herë tjera.

DRINI: Po ashtu është, thjesht humor, s'po e dëmtojmë askënd. Ajo as s'e din për këtë grup.

*(Skena vazhdon – **Drini** e ridërgon foton edhe në grupin e madh të klasës "për gabim", duke ditur mirë se çfarë po bën. Brenda pak minutave, disa bashkënxënës të tjerë e shohin dhe fillojnë të reagojnë me emoji qeshjeje.)*

DRINI: *(duke luajtur "të pafajshëm")* Oo more, m'u dërgu gabimisht ktu, sorry Arta 😅

*(Në këtë moment, mund të "shfaqet" **Arta** – nëse ka aktor për këtë rol – duke parë telefonin e saj, në heshtje, me shprehje të ngrirë. Nëse s'ka aktor për **Artën**, mund të lihet "e padukshme" – vetëm grupi flet për të dhe reagimet e saj imagjinohen.)**

ARTA: *(nëse luhet – me zë të ulët, duke lexuar mesazhet në telefon)…*

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Reflektim i shpejtë me aktorët
- Si u ndjete duke luajtur këtë rol?
- Ishte e vështirë të lexoje ndonjë replikë?
- Pyetjet drejtuar audiencës
- Çfarë do të bënit ndryshe nëse do të ishit në vendin e Blendit, dëshmitarit që e shihte gjithçka por s'ndërhyri shumë?
- Çfarë do të ndryshonit nga sjellja e Deas, e cila ishte pjesëmarrëse aktive por jo "krijuesja" kryesore?
- Çfarë problemi ka me foton e riprodhuar me IA nga Drini?
- A ka pasur ndonjë moment në skenë ku dikush mund ta kishte ndalur situatën para se të shkonte kaq larg? Cili ishte ai moment?
- Nëse do ta 'ripunonit' skenarin nga fillimi, çfarë do të ishte ndryshe që në minutën e parë?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Printimi i skenarit në disa kopje sipas numrit të personazheve
Online	Mund të përdorni platformat online si zoom për t'u mbledhur dhe transferuar diskutimin online. Në vend të skenarit të printuar mund të ndani elektronikisht dokumentin me të rinjtë dhe t'u alokoni nga një rol.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Nëse dikush në grup reagon emocionalisht gjatë apo pas performancës (p.sh. tregon shqetësim real, jo vetëm reflektim mbi rolin), ndërprisni me kujdes dhe ofrojini bisedë private, siç parashikohet edhe në ushtrimet e tjera të manualit.

MJETI 21 - Simulim raportimi i bullizmit kibernetik: Si ta njohim, dokumentojmë dhe raportojmë ngacmimin online mes moshatarëve

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Bullizmi Kibernetik, seksioni 5	45-60 min	15-30 pjesëmarrës	Bazik-mesatar

Qëllimi

T'u mundësojë të rinjve të praktikojnë, përmes një simulimi (jo në llogari reale), hapat konkretë të reagimit, dokumentim, raportim, bllokim dhe kërkim ndihme, kur ata vetë ose dikush që njohin përjeton ngacmim të vazhdueshëm online.

Rezultatet e të nxënit

- Të praktikojnë vendimmarrjen (kur flitet direkt me personin, kur dokumentohet, kur raportohet te platforma, kur përfshihet një i rritur/institucion);
- Të mësojnë si të dokumentojnë siç duhet një rast bullizmi (screenshot me datë/orë/username, pa e fshirë apo ndryshuar provën);
- Të njohin institucionet dhe personat e kontaktit konkretë në Kosovë (shkolla, prindërit, Policia e Kosovës) ku mund të drejtohen kur situata e kalon atë që mund ta zgjidhin vetë mes moshatarëve.

Materialet

- Fletë-mockup të printuara ("interface praktike") që simulojnë skenarë tipikë të bullizmit kibernetik mes moshatarëve (grup klase, "story" anonim, llogari false), të krijuara nga fasilituesi (jo screenshot të llogarive reale të pjesëmarrësve);
- Karta situatash fiktive (6-8 copë), nga forma më e lehtë (koment i vetëm i pakëndshëm nga një shok) te më e rëndë (llogari false e krijuar posaçërisht për të tallur dikë, ose sulm i koordinuar nga një grup klase);
- Fletë "Lista e kontrollit e dokumentimit" (data/ora, emri i përdoruesit/pseudonimi, platforma, përshkrim i shkurtër, screenshot i ruajtur);
- Fletë me kontaktet reale të ndihmës në Kosovë (shih "Përgatitja e fasilituesit");
- Flipchart/shënues për punën në grupe të vogla;
- Projektor/kompjuter (opsional) për të treguar faqet zyrtare të ndihmës (Help Center/Qendra e Sigurisë) të platformave kryesore.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit paraprakisht "interface-in praktik" (fletë të printuara që simulojnë: një grup klase në WhatsApp/Viber ku dikush përjashtohet qëllimisht, një "story" anonime tip "confession" e njohur mes nxënësve, dhe një llogari false e krijuar për t'u tallur me një bashkëmoshatar).

- Përgatit karta situatash fiktive që mbulojnë forma të ndryshme të bullizmit kibernetik: përjashtim i qëllimshëm nga grup online; krijim i një llogarie false me emrin/foton e dikujt për t'u tallur; përhapje e një fotoje/mesazhi privat pa leje brenda shkollës; koment i vetëm i pakëndshëm nga një i njohur; ngacmim i përsëritur me mesazhe nga i njëjti person; sulm i koordinuar nga një grup nxënësish në komentet e një postimi. Ose referohu Aneksit 13 me shembuj kartash.
- Sigurohu që asnjë kartë situate të mos bazohet apo të mund të lidhet me ndonjë ngjarje/person real të njohur nga grupi (shkolla, klasa, qyteti specifik i pjesëmarrësve).
- Përgatit fletën me kontaktet reale të Kosovës, të kontrolluara paraprakisht për vlefshmëri: këshilltari/mësuesi/drejtoria e shkollës, si hapi i parë i natyrshëm për shumicën e rasteve mes moshatarëve; prindi/kujdestari; Policia e Kosovës – numri i urgjencës, për raste me kërcënim apo rrezik të drejtpërdrejtë; Institucioni i Avokatit të Popullit, për raste diskriminimi.
- Nëse do të demonstrosh hapat aktualë të një platforme specifike, kontrollo paraprakisht që hapat në faqet zyrtare të ndihmës të jenë ende të vlefshme.
- Kurrë mos u kërko pjesëmarrësve të hyjnë në llogaritë e tyre reale apo të tregojnë ekranin personal gjatë sesionit – gjithçka mbetet simulim.

Hapat e të nxënit

1. Duke përdorur fletë-mockup-et praktike, diskuto bashkë me grupin nëpër një skenar shembull (p.sh. përjashtimi i qëllimshëm nga grupi i klasës) dhe diskuto hapat e mundshëm të reagimit: a flitet direkt, a dokumentohet, a raportohet, a përfshihet një i rritur.
2. Ndaj pjesëmarrësit në çift ose grupe të vogla (2-3 persona) dhe jepi secilit grup 1-2 karta situatash fiktive, nga niveli më i lehtë te më i rëndë.
3. Kërko që për secilën situatë grupet të vendosin:
   - A është ky bullizëm kibernetik apo konflikt i zakonshëm mes shokëve, dhe pse?
   - A duhet dokumentuar (screenshot me datë/orë)?
   - A duhet raportuar te platforma, dhe/ose bllokuar personi?
   - A duhet përfshirë menjëherë një i rritur/institucion (shkolla, prindi, Policia)?
4. Bashkoni grupet dhe krahasoni vendimet.
5. Praktikoni së bashku "Listën e kontrollit të dokumentimit" me një nga situatat e diskutuara, dhe shqyrtoni fletën me kontaktet reale të ndihmës në Kosovë.
6. Mund të përdorni Kartat ndihmuese për zhvillimin e aktivitetit sipas Aneksit 12

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Pse disa të rinj hezitojnë t'i tregojnë një të rrituri se po përjetojnë bullizëm online, çfarë i frikëson (turp, frikë se do t'u merret telefoni, frikë se s'do të besohen)?
- Në cilat situata mendoni se duhet përfshirë menjëherë shkolla apo edhe Policia, dhe jo vetëm raportimi te platforma?
- Si mund të reagojmë kur jemi dëshmitarë (jo viktima apo autorë) të bullizmit kibernetik ndaj një bashkëmoshatari?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdorni plotësisht fletë-mockup-et e printuara, kartat e situatave dhe fletën me kontaktet e ndihmës.
Online	Projekto faqet zyrtare të ndihmës (Help Center) të platformave aktuale, ose përdor dokument të përbashkët online për kartat e situatave.
Mosha 13-15	Përqendrohuni te dinamikat e grupit të klasës/shkollës (grupe WhatsApp/Viber, përjashtimi social) dhe te roli i mësuesit/prindit si hapi i parë i natyrshëm.
Mosha 15-17	Shtoni skenarë me llogari false dhe "pile-on" në rrjete më publike (Instagram, TikTok, faqe tip "confession"); diskutoni edhe pasojat afatgjata (gjurma digjitale).
Mosha 18-29	Diskutoni bullizmin kibernetik në kontekste profesionale/universitare (grupe pune, forume studentore) dhe rrugën drejt institucioneve formale nëse përfshihet diskriminim.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Sesioni nuk duhet të kërkojë kurrë nga pjesëmarrësit të hyjnë në llogaritë e tyre reale, të tregojnë ekranin personal, apo të përmendin emra/persona real nga shkolla/klasa e tyre gjatë diskutimit të kartave të situatave, gjithçka mbetet simulim me materiale të krijuara nga fasilituesi.

Nëse dikush ndan gjatë sesionit se po përjeton aktualisht bullizëm kibernetik real, mos e trajto atë si “rast studimi” në grup, por ndërprit me kujdes dhe ofroju bisedë private, dhe nëse është e nevojshme, drejtoje te këshilltari i shkollës ose një i rritur i besuar.



6. Mjete për Kapitullin VI - Gjuha e Urrejtjes

Mjetet e këtij kapitulli ndjekin një rrjedhë logjike të manualit ku në fillim prezantohen mjete për identifikimin e gjuhës së urrejtjes, më pas mjete ku analizohet grupi i synuar dhe reagimet në ndalimin e gjuhës së urrejtjes.

MJETI 22 - Kush është shënjestra, analizë e rasteve të anonimizuara të gjuhës së urrejtjes

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli VI - Gjuha e urrejtjes, seksioni 4	60 min	Grupe 20-30 persona	Mesatar

Qëllimi

Të zhvillojë aftësinë e pjesëmarrësve për të identifikuar modele se kush shënjestrohet nga gjuha e urrejtjes.

Materialet

- 6-8 raste studimi të shkurtra, të anonimizuara plotësisht (shembuj të ndërtuar/fiktivë, të bazuar në modele reale, por pa emra, foto apo detaje identifikuese);
- Fletë/poster me "spektrin e gjuhës së urrejtjes" (nga gjuha paragjykuese → gjuha diskriminuese → gjuha e urrejtjes → nxitja për dhunë/paligjshmëri);
- Flipchart, shënues, letra ngjitëse.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit paraprakisht rastet studimore duke i anonimizuar plotësisht – asnjë emër i vërtetë, fotografi, llogari apo detaj që lejon identifikimin e një personi apo ngjarjeje reale.
- Sigurohu që shembujt të përfaqësojnë larmi grupesh të shënjestruara (jo vetëm një grup të vetëm), për të shmangur përforcimin e idesë se vetëm një komunitet preket nga gjuha e urrejtjes.
- Përgatit rregulla themelore diskutimi: respekt, pa gjeneralizime për grupe reale, ndalim i përsëritjes fjalë për fjalë të shprehjeve më të rënda të urrejtjes.

Hapat e të nxënit

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe shpërndani nga 2-3 raste studimi çdo grupi. Kërkojuni të lexojnë rastet dhe të identifikojnë: kush shënjestrohet, çfarë karakteristike i lidh rastet e ndryshme, dhe ku do ta vendosnin secilin rast në "spektrin e gjuhës së urrejtjes".

Mbani parasysh që disa raste mund të mos jenë të qarta, kjo është pjesë e qëllimshme e ushtrimit, pasi shumë situata reale janë kufitare.

Pas punës në grupe, bashkoni të rinjtë për të krahasuar vendosjet përgjatë spektrit dhe për të diskutuar arsyetimin pas tyre.

Më pas, kaloni te pyetja qendrore: a ekzistojnë modele të përbashkëta te ai që shënjestrohet (identitet, dukje, gjuhë, prejardhje)?

Rastet e studimit:

Rasti 1 - Koment nën një postim në rrjete sociale

Në një qytet të Kosovës, një familje nga komuniteti Rom/Ashkali/Egjiptian lëviz në një lagje tjetër për arsye ekonomike. Dikush publikon një foto të shtëpisë së re me komentin: "*Këta po vijnë e po marrin ndihma sociale falas, ndërsa ne punojmë për çdo gjë. S'duhet t'u lejohet të vendosen këtu.*" Nën postim, komente të tjera përsërisin se "të gjithë janë njësoj", "vjedhin", dhe përdorin terma përçmues të njohur ndaj këtyre komuniteteve.

Pika për diskutim: A është ky koment i parë kritikë ndaj sistemit të ndihmave sociale, apo shënjestrim i identitetit etnik? Ku e shohim ndryshimin mes komentit të parë dhe atyre që vijnë?

Rasti 2 - Mesazh në një grup lokal Viber/Facebook

Në një grup privat për shpërndarje "lajmesh", dikush publikon se dy vajza janë parë duke ecur së bashku, duke mbajtur duart, në qendër të qytetit. Postimi shkruan: *"Kjo s'është pjesë e kulturës e traditës sonë, s'duhet lejuar publikisht."* Disa përgjigje sugjerojnë që "dikush duhet t'u tregojë se ku janë" dhe se "s'kanë vend të shfaqen kështu këtu".

Pika për diskutim: Ku ndryshon paragjykimi i shprehur në koment nga kërcënimi i nënkuptuar në përgjigjet pasuese? A ka moment kur gjuha kalon prej "mospëlqimi kulturor" në nxitje për dhunë?

Rasti 3 - Diskutim në komentet e një artikulli online për një komunitet fetar/etnik pakicë

Një artikull raporton për restaurimin e një kishe ortodokse në një zonë me shumicë shqiptare muslimane. Nën artikull, një koment thotë: *"Nuk kam problem me fenë e tyre, por s'më pëlqen që po investohet aq shumë atje ndërsa ne s'kemi investuar aspak në xhamitë tona."* Një koment tjetër shkon më tej: *"Këta gjithmonë kanë synuar të na zëvendësojnë, s'janë pjesë e vendit, janë rrezik."* Një i tretë shkruan drejtpërdrejt se "duhet ndalur" projekti dhe përdor gjuhë kërcënuese ndaj komunitetit që e frekuenton kishën.

Pika për diskutim: Tre komente, tre pika të ndryshme në spektër. Cili mbetet brenda diskutimit legjitim (p.sh. për shpërndarjen e fondeve publike)? Ku fillon shënjestrimi i identitetit etnik/fetar si i tillë?

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Cilat karakteristika u përsëritën më shpesh te personat/grupet e shënjestruara në rastet tona?
- Pse gjuha e urrejtjes shpesh synon veçori që personi nuk mund t'i ndryshojë (identitetin, prejardhjen, besimin)?
- Ku e vendosët kufirin mes kritikës legjitime dhe gjuhës që shënjestron identitetin?
- Si mund ta njohim një model shënjestrimi pa e përdorur atë vetë si stereotip?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdorni rastet studimore të printuara paraprakisht; përdorni flipchart për "spektrin" në vend të mjeteve digjitale.
Online	Ndani rastet në dokumente të përbashkëta (Google Docs); përdorni "breakout rooms" në Zoom për punën në grupe të vogla.
Mosha 15-17	Përdorni raste më të thjeshta, të kufizuara në kontekstin shkollor/të grupmoshës (p.sh. bullizëm me bazë identiteti); shmangni shembuj shumë politikë.
Mosha 18-29	Shtoni raste nga hapësira publike digjitale (komente nën lajme, forume) dhe diskutoni rolin e algoritmeve në përhapjen e gjuhës së urrejtjes.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Rastet e përdorura duhet të jenë gjithmonë të anonimizuara/fiktive, asnjëherë të mos përmbajnë emra, fotografi apo detaje që lejojnë identifikimin e personave apo ngjarjeve reale, veçanërisht të të miturve. Mos u kërkoni pjesëmarrësve të përsërisin fjalë për fjalë shprehjet më të rënda të urrejtjes; mjafton përshkrimi i tyre. Fasilituesi duhet të jetë veçanërisht i vëmendshëm nëse diskutimi kalon në gjeneralizime për grupe reale të pranishme në grup, dhe të ndërhyjë menjëherë për ta risjellë diskutimin te analiza e modeleve, jo te gjykimi i individëve.

MJETI 23 - Gjurmët digjitale, si "ndjek" një postim lëndues për vite me radhë

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli V - Gjuha e urrejtjes, seksioni 4 dhe 5	45-60 min	Grupe 10-20 persona	Mesatar

Qëllimi

Të kuptojë se si një postim lëndues, një sulm i koordinuar apo një koment i vetëm i gjuhës së urrejtjes mund të rishfaqet, të kopjohet dhe të ndjekë një person për vite me radhë, edhe pasi është fshirë nga burimi origjinal – dhe të reflektojë mbi pasojat afatgjata të kësaj "gjurme dixhitale".

Materialet

- Letra flipchart ose një tabelë kohore (timeline) e printuar/digjitale për të hartuar "udhëtimin" e postimit;
- Shënues/karta ngjitëse me ngjyra të ndryshme për të shënuar lloje të ndryshme "rishfaqjesh" (screenshot, rishpërndarje, kërkim me emër, arkiv).

Përgatitja e fasilituesit

- Njihu paraprakisht me konceptet: gjurma digjitale (digital footprint), "e drejta për t'u harruar", dhe dinamikat e "pile-on" (kur shumë persona bashkohen për të sulmuar dikë online, shpesh pa njohur kontekstin e plotë).

Hapat e të nxënit

Prezantoni skenarin fiktiv të grupit dhe kërkojuni pjesëmarrësve, në grupe të vogla, të ndërtojnë një tabelë kohore (timeline) të "jetës" së postimit: nga publikimi fillestar, te reagimet e para, te rishpërndarja, te screenshot-et që qarkullojnë pavarësisht nga fshirja e postimit origjinal, e deri te rishfaqja e mundshme vite më vonë (p.sh. në një kërkim online për emrin e personit).

Për çdo pikë të tabelës kohore, grupet duhet të diskutojnë: kush kishte kontroll mbi përmbajtjen në atë moment, dhe a mund të ishte ndalur "udhëtimi" i saj.

Në fund, grupet ndajnë tabelat e tyre kohore me njëri-tjetrin dhe diskutohet së bashku pse fshirja e një postimi origjinal shpesh nuk mjafton për ta ndalur përhapjen e tij.

Skenari: "Komenti nën fotografinë e maturës"

Konteksti fillestar

Blerta (emër fiktiv) është nxënëse në klasën e 12-të në një qytet të Kosovës. Në prag të ceremonisë së maturës, ajo publikon në Instagram një foto me fustanin e saj për atë mbrëmje. Fotoja merr shumë "like", por nën të, një bashkënxënës i saj shkruan një koment poshtërues për fustanin që përshtatet me praktikat e saj fetare, duke përdorur gjuhë fyese dhe sarkastike.

Muaji 1 - Reagimi fillestar

Disa shokë të klasës "pëlqejnë " komentin dhe shtojnë emoji qeshjeje. Të tjerë përgjigjen me komente të ngjashme, duke e kthyer atë në një lloj "shakaje të klasës". Blerta e fshin foton brenda pak orësh, por disa

nxënës kanë bërë tashmë screenshot dhe e kanë dërguar në grupin e klasës në ËhatsApp/Viber, me titullin "shikoni çfarë i thanë Blertës".

Muaji 1-2 - Rishpërndarja

Screenshot-i qarkullon më tej – nga grupi i klasës në grupe të tjera shoqërore, madje edhe në një "stories" anonim në një faqe humori lokal të njohur për të postuar screenshot-e nga jeta e shkollave në qytet (një lloj faqeje "confession" shumë e njohur në mesin e të rinjve në Kosovë). Emri i Blertës nuk përmendet drejtpërdrejt në faqe, por shkolla dhe klasa po, dhe shumë e njohin menjëherë se për kë bëhet fjalë.

Muaji 3 - "Pile-on" (sulmi i koordinuar)

Disa përdorues të panjohur, që nuk e njohin fare Blertën, fillojnë të komentojnë nën postimin e ridistribuar, duke shtuar sharje të reja dhe duke "etiketuar" llogari të tjera për t'i thirrur të shohin. Askush nuk pyet për kontekstin fillestar – postimi është bërë tashmë "argëtim publik".

Viti 1 - Fshirja e postimit origjinal

Blerta, e mbështetur nga familja, arrin ta bëjë të fshihet postimi nga faqja e "confession". Por screenshot-et vazhdojnë të qarkullojnë privatisht mes nxënësve të shkollave të tjera në qytet, të cilët e kanë marrë nga shokë të shokëve.

Viti 2 - Arkivimi dhe kërkimi

Dikush e ka ruajtur screenshot-in në një folder personal "screenshot-esh humori" dhe e ripostuar rastësisht, pa qëllim keqdashës, në një grup tjetër vite më vonë – thjesht sepse "i pëlqeu koha kur qeshën". Postimi origjinal nuk ekziston më askund publikisht, por vetë ngjarja "jeton" në kujtesën kolektive të bashkëmoshatarëve.

Viti 4 - Rishfaqja gjatë aplikimit për punë

Blerta aplikon për një punë të parë pas universitetit. Punëdhënësi i ardhshëm, si pjesë e një kontrolli rutinë në rrjete sociale, kërkon emrin e saj dhe gjen një koment të vjetër në një grup publik Facebook ku dikush, duke rikujtuar "kohët e shkollës", përmend shkurtimisht incidentin – pa keqdashje, por duke e nxjerrë sërish në pah emrin e saj në një kontekst publik të kërkueshëm.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Pse fshirja e një postimi origjinal shpesh nuk e ndalon përhapjen e tij?
- Cilat janë pasojat afatgjata (psikologjike, sociale, profesionale) të mbetjes së një përmbajtjeje lënduese online?
- Kush mban përgjegjësi në një "pile-on" – vetëm personi që ka postuar i pari, apo edhe ata që e kanë rishpërndarë/komentuar më pas?
- Çfarë mund të bëjë dikush për ta menaxhuar apo kufizuar gjurmën e tij/saj digjitale?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdorni skenarin e printuar dhe ndërtoni tabelën kohore me letra flipchart dhe karta ngjitëse.
Online	Përdorni një tabelë kohore digjitale të përbashkët (p.sh. Miro) ku grupet shtojnë "pikat" e udhëtimit të postimit.
Mosha 15-17	Përqendrohuni te shembuj nga konteksti shkollor (grupe bisedash, aplikacione mesazhesh mes shokëve).
Mosha 18-29	Shtoni shembuj nga konteksti profesional (kërkimi i emrit nga punëdhënësit) dhe diskutoni "të drejtën për t'u harruar" si koncept ligjor.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

- Skenari i përdorur duhet të mbetet gjithmonë fiktiv dhe i paidentifikueshëm. Fasilituesi duhet të jetë i kujdesshëm nëse tema prek përvoja personale të të rinjve.
- Nëse dikush ndan një përvojë të tillë, mos e analizoni publikisht si "studim rasti"; kaloni me delikatesë dhe ofroni mbështetje/referim privat pas sesionit.

MJETI 24 - Përmbajtja e gjeneruar nga IA dhe gjuha e urrejtjes nëpër platforma

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli VI - Gjuha e urrejtjes, seksioni 5 dhe 6	45-60 min	Grupe 20-30 persona	Mesatar

Qëllimi

Të kuptojmë si teknologjitë e reja, veçanërisht përmbajtja e gjeneruar nga inteligjenca artificiale po e bëjnë gjuhën e urrejtjes më të vështirë për t'u gjurmuar, dhe lehtësisht të qarkullueshme në paltforma.

Rezultatet e të nxënit

- Të kuptojnë se si përmbajtja e gjeneruar nga IA (foto/video/tekst false ose të shtrembëruara) mund të përdoret për të krijuar apo amplifikuar gjuhën e urrejtjes ndaj individëve/komuniteteve;
- Të vizualizojnë procesin e "kërcimit ndër-platformë" (cross-platform jump) – nga një mesazh/imazh në një grup privat, drejt screenshot-it, shishpërndarjes publike, dhe amplifikimit;
- Të reflektojnë pse grupet e cënueshme (etnike, fetare, gjinore, minoritare) janë veçanërisht të ekspozuara ndaj gjuhës së urrejtjes të "ushqyer" nga përmbajtja e gjeneruar artificialisht;
- Të njohin kufizimet e vetë platformave dhe të IA-së (moderim automatik) në zbulimin dhe heqjen e kësaj përmbajtjeje.

Materialet

- Poster/flipchart me skemën e "kërcimit ndër-platformë" (Grup privat → Screenshot → rishpërndarje publike → Amplifikim);
- 4-5 skenarë të shkurtër fiktivë, të anonimizuar plotësisht, që përshkruajnë përmbajtje të gjeneruar nga IA e përdorur për të synuar një person/komunitet (shih më poshtë);
- Shënues me ngjyra, letra ngjitëse;
- Projektor (opsional), për të treguar shembuj publikë e të njohur gjerësisht të diskutimit rreth IA-së dhe dezinformimit (pa gjeneruar apo shfaqur vetë përmbajtje reale dëmtuese).

Përgatitja e fasilituesit

- Njihu me konceptet bazë: përmbajtje e gjeneruar nga IA (deepfake, imazhe/tekste artificiale), dhe si moderimi automatik i platformave (p.sh. sistemet e bazuara në IA që Facebook i përdor për të hequr raste gjuhe urrejtjeje)
- Përgatit paraprakisht skenarët fiktivë (asnjë emër real, foto reale apo person i identifikueshëm) që tregojnë përdorimin e AI-së për krijimin/amplifikimin e gjuhës së urrejtjes.
- Sigurohu që shembujt të mbulojnë grupe të ndryshme të cënueshme (jo vetëm një komunitet), për të mos përforcuar idenë se vetëm një grup preket.

- Përgatit rregulla themelore diskutimi: askush s'duhet të përshkruajë apo të "rindërtojë" me detaje se si krijohet përmbajtje e tillë.
- Mendo paraprakisht për shembuj real, publikisht të që mund të përmenden shkurtimisht si kontekst, pa u zgjeruar në detaje teknike.

Hapat e të nxënit

Shpjegojini shkurt të rinjve se gjuha e urrejtjes sot nuk mbetet e kufizuar në një platformë. Një mesazh apo imazh i krijuar (ndoshta edhe me ndihmën e IA-së) në një grup privat mund të bëhet screenshot dhe të arrijë publikisht brenda minutash. Përmendni shkurtimisht se platformat përdorin AI për ta zbuluar dhe hequr këtë përmbajtje, por sistemet automatike shpesh pa kontekst lokal dhe gjuhë lokale (simbolika, fjalë me shumë kuptime) dhe mbeten pas në heqjen e kontentit kur ai material ka qarkullaur edhe në platforma të tjera.

Më pas ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe jepuni secilit grup 1 skenar fiktiv (shih më poshtë). Kërkojuni të vizatojnë "udhëtimin" e përmbajtjes në flipchart, duke përdorur skemën: Origjina → Grupi/hapësira e parë → Si "kërceu" më tej → Ku arriti në fund. Për secilin skenar, grupet duhet të diskutojnë:

- Cila është veçoria "e re" këtu që lidhet me AI-në (jo thjesht gjuhë urrejtjeje "tradicionale")?
- A do të kishte ndodhur e njëjta gjë po të mos ekzistonte teknologjia e sotme e IA-së?
- Kush e ka të vështirë ta gjurmojë/ndalë këtë përmbajtje, dhe pse?

Secili grup prezanton skemën e tij. Më pas ngrini pyetje/diskutim në grup.

Skenarët fiktivë për punë në grupe

Skenari 1

Në një grup privat Telegram, dikush shpërndan një imazh të krijuar me IA që tregon "prova" false se një grup i të rinjve nga një komunitet i caktuar etnik po planifikon diçka të dëmshme në qytet. Imazhi duket realist, megjithëse është plotësisht i trilluar. Brenda orësh, screenshot i imazhit qarkullon në grupe publike Facebook të qytetit, të shoqëruar me komente alarmante.

Skenari 2

Një zë i klonuar me IA (që imiton zërin e një personazhi publik lokal, fiktiv në këtë skenar) qarkullon në një audio të shkurtër ku "thuhet" diçka fyese ndaj një komuniteti fetar. Audioja fillimisht ndahet si "shaka" në një grup miqsh, por më pas ridërgohet si "provë reale" në platforma publike, pa u sqaruar se është e krijuar artificialisht.

Skenari 3

Dikush përdor një aplikacion IA për të "ndryshuar" fytyrën e një personi në një foto ekzistuese, duke e vendosur atë në një kontekst poshtërues të lidhur me orientimin e tij/saj seksual. Foto e ndryshuar postohet fillimisht anonimisht, më pas arrin te bashkëmoshatarët e personit real dhe qarkullon si "e vërtetë".

Skenari 4

Një tekst i gjeneruar nga IA (p.sh. një "artikull lajmi" i trilluar plotësisht) pretendon se një grup refugjatësh/migrantësh të vendosur përkohësisht në një qytet të Kosovës ka kryer një krim që s'ka ndodhur në realitet. "Artikulli" ndahet fillimisht në një grup lokal Facebook, dhe brenda pak orësh e marrin edhe faqe të tjera lajmesh jo-serioze, duke e përhapur si informacion real.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Si e bën AI-ja gjuhën e urrejtjes më "bindëse" apo më të vështirë për t'u dalluar nga e vërteta?
- Pse mendoni se grupet e cenueshme (minoritetet etnike, fetare, komunitetet LGBTI+, refugjatët/migrantët) janë veçanërisht të ekspozuara ndaj kësaj forme të re të gjuhës së urrejtjes?
- Pse "kërcimi" nga një grup privat drejt hapësirës publike e bën aq të vështirë ndalimin/heqjen e përmbajtjes, edhe kur platforma origjinale e heq atë?
- Çfarë mund të bëjë një i ri kur has përmbajtje që dyshon se është e krijuar artificialisht dhe synon të nxisë urrejtje ndaj një grupi?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdorni skenarët e printuar.
Online	Përdorni një aplikacion të takimit online pë të diskutuar skenarët dhe eksploroni mënyrën e moderimit të kontentit nga platformat duke kërkuar online më shumë lidhur me këtë nga secila platformë.
Mosha 15-17	Përqendrohuni te shembuj nga konteksti shkollor (grupe bisedash, aplikacione mesazhesh mes shokëve).
Mosha 18-29	Krahasoni informacionin e publikuar nga platformat për moderimin e kontetit për gjuhën e urrejtjes.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

- Skenari i përdorur duhet të mbetet gjithmonë fiktiv dhe i paidentifikueshëm. Fasilituesi duhet të jetë i kujdesshëm nëse tema prek përvoja personale të të rinjve.
- Nëse dikush ndan një përvojë të tillë, mos e analizoni publikisht si "studim rasti"; kaloni me delikatesë dhe ofroni mbështetje/referim privat pas sesionit.

MJETI 25 - Lojë me role: "Nga ekrani im te ekrani i gjithkujt"

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli VI - Gjuha e urrejtjes, seksioni 7 dhe 8	45-60 min	Grupe 15-25 persona	Mesatar - i avancuar

Qëllimi

Përmes një loje me role, të rinjtë të përjetojnë vetë, nga këndvështrime të ndryshme gjuhën e urrejtjes dhe të kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë e secilit aktor në këtë zinxhir (krijuesi, ndarësi i parë, dëshmitari, platforma, personi/grupi i shënjestruar).

Rezultatet e të nxënit

- Të përjetojnë, përmes lojës me role, shpejtësinë dhe pakontrollueshmërinë e përhapjes së përmbajtjes së gjeneruar nga IA;
- Të identifikojnë pikat konkrete në zinxhir ku dikush mund të kishte ndërhyrë për ta ndalur përhapjen;
- Të kuptojnë ndryshimin mes përgjegjësisë së "krijuesit" origjinal dhe atyre që e rishpërndajnë pa e verifikuar;
- Të zhvillojnë ndjeshmëri ndaj pasojave për personin/grupin e shënjestruar, edhe kur ata vetë nuk janë "personazhi kryesor" i skenës.

Materialet

- Karta rolesh të printuara (një për secilin rol, shih më poshtë);
- Fletë me përshkrimin e shkurtër të skenarit, për t'ua lexuar/shpërndarë 'aktorëve' para fillimit;
- Hapësirë e mjaftueshme për 5-6 "stacione" (secili stacion përfaqëson një platformë/hapësirë – shih më poshtë);
- Shënues, letra ngjitëse ose fletë A4 për të shënuar emrin e secilit "stacion".

Përgatitja e fasilituesit

- Lexoje paraprakisht skenarin dhe kartat e roleve, në mënyrë që të jeni gati t'u përgjigjeni pyetjeve gjatë përgatitjes së aktorëve.
- Vendosni paraprakisht "stacionet" në hapësirën e dhomës/sallës, secilin të shënuar me një fletë: *Stacioni 1 - Grupi privat, Stacioni 2 - Screenshot & Ridërgimi te miku, Stacioni 3 - Grupi publik i qytetit, Stacioni 4 - Faqja/llogaria publike, Stacioni 5 - Personi/grupi i shënjestruar.*
- Sigurohu që roli i "personit/grupit të shënjestruar" të mos i jepet dikujt që, sipas dijenisë suaj, i përket vetë atij komuniteti të cenueshëm të përmendur në skenar (etni, fe, orientim seksual, status migrator), për të shmangur ekspozim të panevojshëm emocional.
- Përgatit paraprakisht rregullat bazë: askush s'duhet të përshkruajë me detaje teknike si krijohet përmbajtje e rreme me IA, pasi ky nuk është qëllim i ushtrimit.

Hapat e të nxënit

Shpjegoni konceptin shkurtimisht: sot do të "luajmë" fizikisht rrugëtimin e një përmbajtjeje të krijuar me IA, duke lëvizur nëpër "stacione" të ndryshme që përfaqësojnë platforma/hapësira digjitale. Ndani rolet e mëposhtme (mund të jepen individualisht ose në çift, varësisht madhësisë së grupit):

- Krijuesi/Krijuesja – personi që krijon fillimisht përmbajtjen me AI dhe e ndan në një grup privat
- Miku/Miqtë e parë – personat në grupin privat që e shohin, disa qeshin, njëri bën screenshot
- Ndarësi publik – personi që e ridërgon screenshot-in në një grup publik të qytetit, "pa qëllim keq", vetëm "sepse ishte interesante"
- Administratori i faqes/llogarisë publike – personi që e poston zyrtarisht në një faqe/llogari me shumë ndjekës
- Komentuesit (2-3 role) – persona të panjohur që komentojnë, disa duke e përhapur më tej, njëri duke shprehur dyshim ("a është kjo edhe e vërtetë?")
- Personi/grupi i shënjestruar – personi/komuniteti për të cilin bëhet fjalë në përmbajtje (mund të luhet edhe "jashtë skenës", vetëm i përmendur nga një zë tregimtar, nëse grupi nuk ndihet rehat ta ketë si rol)
- "Zëri i verifikimit" (rol opsional, shtesë) – një person që përfaqëson dikë që përpiqet të verifikojë nëse përmbajtja është reale, para se ta ndajë më tej

Jepuni aktorëve fletën me skenarin dhe kartat e tyre të rolit. Lërini 5-6 minuta të familjarizohen me rolin dhe të mendojnë si do ta "luajnë" atë kur t'u vijë radha te stacioni i tyre.

Aktorët lëvizin fizikisht nga stacioni në stacion, duke "bartur" simbolikisht përmbajtjen (mund të përdoret një fletë/kartolinë që përfaqëson vetë "imazhin/mesazhin"). Në secilin stacion, aktori përkatës e lexon/luan shkurtimisht replikën e tij (shih skenarin), dhe kalon "përmbajtjen" te stacioni tjetër. Audienca (pjesa tjetër e grupit) e ndjek këtë lëvizje fizikisht ose e vëzhgon nga vendi.

Kur "përmbajtja" arrin te stacioni i personit/grupit të shënjestruar, ndaloni lojën. Mos e lejoni skenën të vazhdojë drejt një zgjidhjeje të gatshme.

Drejtohu fillimisht aktorëve, pastaj audiencës, me pyetjet e reflektimit më poshtë. Nëse koha e lejon, ftoni dikë nga audienca të "zëvendësojë" njërin aktor (p.sh. Ndarësin publik ose një Komentues) dhe të tregojë çfarë do të bënte ndryshe në atë stacion specifik, pastaj vazhdoni simulimin nga ai moment për të parë si ndryshon "udhëtimi".

Skenari (fleta që u shpërndahet aktorëve)

"Dikush krijon, me anë të një aplikacioni IA, një imazh 'realist' që tregon –në mënyrë të trilluar plotësisht– një grup të rinjsh nga një komunitet i caktuar (etnik/fetar/migrator, sipas zgjedhjes së fasilitatorit) duke bërë diçka të dëmshme në qytet. E ndan fillimisht si 'shaka' në një grup të ngushtë miqsh. Brenda pak orësh, imazhi arrin, hap pas hapi, te një faqe publike me shumë ndjekës, ku qindra persona e komentojnë, disa duke e besuar si të vërtetë.

Krijuesi/Krijuesja (*Stacioni 1*): "Shikoni çka bëra me këtë aplikacion, duket sikur ka ndodhur vërtet! Po e dërgoj vetëm te ju, mos e nxirrni jashtë grupit."

Miku/Miqtë e parë (*Stacioni 1→2*): "Hahaha kjo është shumë e mirë, po ia dërgoj edhe shokut tim, ai do ta gjejë interesante." (bën screenshot pa pyetur krijuesin)

Ndarësi publik (*Stacioni 3*): "Këtë duhet ta shohë tërë qyteti, po e postoj në grupin tonë publik, njerëzit duhet ta dinë çka po bëjnë këta." (pa e verifikuar nëse është reale)

"Zëri i verifikimit" (*mund të "ndërhyjë" në çdo stacion*): "Prisni pak, a jemi të sigurt që kjo është reale? Dukej pak çuditshëm ajo pjesa e imazhit..." (shpesh nuk dëgjohet nga të tjerët)

Administratori i faqes publike (*Stacioni 4*): "Kjo do të marrë shumë reagime, po e postoj tani në faqen tonë me 10,000 ndjekës."

Komentuesit (*Stacioni 4→5*):

- "Nuk kam qenë kurrë dakord me këta njerëz, tash e kam edhe provën!"
- "Dikush duhet të bëjë diçka për këtë, s'mund të vazhdojë kështu!"
- *(një komentues i vetëm, më i qetë)*: "A e ka verifikuar dikush këtë para se ta postojë...?"

Personi/grupi i shënjestruar (*Stacioni 5 – mund të luhet "jashtë skenës"*): (qëndron në heshtje, duke parë telefonin/ekranin, ndërsa komentet vazhdojnë të shtohen)

Pyetje për reflektim dhe diskutim

Për aktorët:

- Si u ndjetë duke luajtur rolin tuaj – a e ndjetë veten "fajtor", "të pafajshëm", apo diçka mes tyre?
- A kishit dyshuar në ndonjë moment nëse ajo që po ndanit ishte e vërtetë?

Për të gjithë grupin:

- Në cilin stacion mendoni se dikush mund ta kishte ndalur më lehtë "udhëtimin" e kësaj përmbajtje-je?
- Pse mendoni se "Zëri i verifikimit" shpesh nuk dëgjohet apo nuk merret parasysh në situata të tilla?
- Si ndryshon përgjegjësia e "Krijuesit" nga ajo e "Ndarësit publik" apo e "Komentuesve"? A janë të gjithë njësoj përgjegjës?
- Pse mendoni se përmbajtja e krijuar me AI mund të jetë edhe më "bindëse" se gjuha e zakonshme e urrejtjes?
- Si mendoni se ndihet personi/grupi i shënjestruar në Stacionin 5, edhe pse s'ka marrë pjesë fare në krijimin e kësaj përmbajtjeje?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdorni skenarët e printuar dhe ndërtoni tabelën kohore me letra flipchart dhe karta ngjitëse.
Online	Përdorni një aplikacion të takimit online për të diskutuar skenarët dhe eksploroni mënyrën e moderimit të kontentit nga platformat duke kërkuar online më shumë lidhur me këtë nga secila platformë.
Mosha 15-17	Përqendrohuni te shembuj nga konteksti shkollor (grupe bisedash, aplikacione mesazhesh mes shokëve).
Mosha 18-29	Krahasoni informacionin e publikuar nga platformat për moderimin e kontetit për gjuhën e urrejtjes.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

- Skenari i përdorur duhet të mbetet gjithmonë fiktiv dhe i paidentifikueshëm. Fasilituesi duhet të jetë i kujdesshëm nëse tema prek përvoja personale të të rinjve.
- Nëse dikush ndan një përvojë të tillë, mos e analizoni publikisht si "studim rasti"; kaloni me delikatesë dhe ofroni mbështetje/referim privat pas sesionit.

MJETI 26 - Simulim raportimi: Si të raportosh, bllokosh dhe dokumentosh abuzimin online

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli VII - Gjuha e urrejtjes, seksioni 8	45 min	15-30 pjesëmarrës	Bazik - mesatar

Qëllimi

T'u mundësojë të rinjve hapat konkretë të raportimit, bllokimit dhe dokumentimit të abuzimit online, si dhe të njohin ku dhe si mund të kërkojnë ndihmë reale.

Materialet

- Fletë-mockup të printuara ("interface praktike") që simulojnë një postim të përgjithshëm dhe një menu raportimi gjenerike me hapa (Raporto → Zgjidh arsyen → Konfirmo → Bllokо), të krijuara nga fasilituesi (jo screenshot të llogarive reale të pjesëmarrësve);
- Fletë "Lista e kontrollit e dokumentimit" (data/ora, emri i përdoruesit, platforma, përshkrim i shkurtër, screenshot i ruajtur);
- Fletë me numrat/kontaktet reale të ndihmës në Kosovë (shih "Përgatitja e fasilituesit");
- Projektor/kompjuter (opsional) për të treguar faqet aktuale të ndihmës (Help Center) të platformave kryesore, drejtpërdrejt nga faqet zyrtare, pa hyrë në asnjë llogari personale.

Përgatitja e fasilituesit

- Përgatit paraprakisht "interface-in praktik" (një fletë e printuar me kuti të vizatuara: "Postim shembull" + butona "Raporto"/"Bllokо"/"Dokumento", secili duke çuar te një "hap" tjetër i printuar në një fletë tjetër).
- Përgatit fletën me kontakte në Kosovë, të kontrolluara paraprakisht për vlefshmëri: Policia e Kosovës, linja falas për viktima krimesh, përfshirë kërcënime serioze; Institucioni i Avokatit të Popullit, për raste diskriminimi; këshilltari/mësuesi/drejtoria e shkollës, si hapi i parë i natyrshëm për shumicën e rasteve mes të rinjve.
- Nëse do të demonstrosh hapat aktualë të një platforme specifike, hap paraprakisht faqet zyrtare të ndihmës (Help Center/Qendra e Sigurisë) të platformës përkatëse dhe kontrollo që hapat e sakta të jenë ende të vlefshme, pasi këto ndryshojnë herë pas here.
- Kurrë mos u kërko pjesëmarrësve të hyjnë në llogaritë e tyre reale ose të raportojnë përmbajtje reale gjatë sesionit, gjithçka duhet të mbetet simulim.

Hapat e të nxënit

Prezanto konceptin e përgjithshëm: shumica e platformave ndjekin një logjikë të ngjashme raportimi, identifikimi i përmbajtjes, zgjedhja e arsyes (ngacmim, gjuhë urrejtjeje, kërcënim etj.), dhënia e kontekstit shtesë, dhe dërgimi i raportit; shpesh ekziston edhe opsioni për të bllokuar përdoruesin njëkohësisht.

Duke përdorur fletë-mockup-in praktik (ose faqet zyrtare të ndihmës, të projektuara), ec bashkë me grupin nëpër hapat e plotë të raportimit dhe bllokimit, pa përdorur llogari reale.

Më pas ndaj me pjesëmarrësit në grupe me nga dy persona dhe jepu secilit grup një ose më shumë situata fiktive (nga më e lehta te më serioze, përfshirë një rast që përfshin gjuhë urrejtjeje). Kërko që për secilën situatë të vendosin: a raportohet, a bllokohet, a dokumentohet, dhe a duhet përfshirë menjëherë një i rritur/institucion (shkollë, prind, Policia e Kosovës, Avokati i Popullit).

Aneksi 14 permban tabela praktike për ushtrimin.

Pyetje për reflektim dhe diskutim

- Pse është e rëndësishme të dokumentosh (screenshot) përpara se të bllokosh dikë?
- Në cilat situata mendoni se raportimi te vetë platforma nuk mjafton, dhe duhet përfshirë Policia e Kosovës apo një institucion tjetër?
- Pse disa të rinj hezitojnë të raportojnë apo të kërkojnë ndihmë, edhe kur diçka i shqetëson vërtet?
- A e dinit se ekzistojnë linja ndihme dhe institucione konkrete në Kosovë për raste serioze? A do t'i përdornit, dhe pse (jo)?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përdorni plotësisht fletë-mockup-et e printuara dhe fletën me kontaktet e ndihmës; asnjë nevojë për internet.
Online	Projekto faqet zyrtare të ndihmës (Help Center) të platformave aktuale (të përditësuara para sesionit), ose përdor një mjet online mockup në vend të llogarive reale.
Mosha 15-17	Përqendrohuni te platformat/aplikacionet më të përdorura nga kjo grupmoshë (Instagram, TikTok, Snapchat) dhe te roli i shkollës si hapi i parë; përfshi gjithmonë opsionin "trego një të rritur" si hap i vlefshëm.
Mosha 18-29	Shtoni skenarë nga konteksti profesional (LinkedIn, email pune) dhe diskutoni dokumentimin për qëllime ligjore, si dhe rrugën drejt Avokatit të Popullit për raste diskriminimi në punësim.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Sesioni nuk duhet të kërkojë kurrë nga pjesëmarrësit të hyjnë në llogaritë e tyre reale, të raportojnë përmbajtje reale, apo të ndajnë ekranin e tyre personal. Gjithçka mbetet simulim me materiale të krijuara nga fasilituesi.

MJETI 27 - Rasti Vejdeland kundër Suedisë - Kur gjuha e urrejtjes në shkollë përfundon në gjykatë

Lidhja me manualin	Koha	Formati	Niveli
Kapitulli VI - Gjuha e urrejtjes, seksioni 9	60 min	Grup i plotë, me analizë në grupe të vogla	E avancuar

Qëllimi

Të analizojë, përmes një rasti real dhe të dokumentuar mirë (Vejdeland dhe të Tjerë kundër Suedisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012), se si gjuha e urrejtjes e shpërndarë në një ambient shkollor mund të ketë pasoja reale ligjore, dhe si gjykatat e nivelit më të lartë evropian arsyetojnë kufirin mes lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes nga gjuha e urrejtjes.

Rezultatet e të nxënit

- të njohin faktet kryesore të një rasti real gjyqësor evropian për gjuhën e urrejtjes në kontekst shkollor;
- të kuptojnë arsyetimin ligjor pas kufizimit të lirisë së shprehjes kur ajo shndërrohet në gjuhë urrejtjeje;
- të analizojnë pasojat institucionale (shkollore, ligjore) të shpërndarjes së materialeve që shënjestrojnë një grup identitar;
- të reflektojnë mbi rolin e shkollës si hapësirë e mbrojtur nga gjuha e urrejtjes.

Materialet

- Përmbledhje e shkurtër, e përgatitur nga fasilituesi, e fakteve të rastit Vejdeland dhe të Tjerë kundër Suedisë (2012);
- Fletë me pyetje udhëzuese për analizën e rastit;
- Flipchart/shënues për diskutimin në grup.

Përgatitja e fasilituesit

- Njihu me faktet e rastit: në dhjetor 2004, katër persona (jo nxënës të shkollës) hynë në një shkollë të mesme në Suedi dhe shpërndanë rreth 100 fletushka në/mbi dollapët e nxënësve, që përshkruanin homoseksualitetin si "prirje seksuale devijante" me "efekt moralisht shkatërrues" për shoqërinë, dhe e lidhnin atë me përhapjen e HIV/AIDS-it.
- Drejtoresha e shkollës ndërhyri dhe i largoi personat nga ambienti shkollor. Autorët u dënuan fillimisht nga Gjykata e Qarkut për "nxitje kundër një grupi kombëtar apo etnik"; Gjykata e Apelit i shfajësoi, por Gjykata e Lartë e Suedisë i dënoi përfundimisht më 6 korrik 2006.
- Autorët e çuan çështjen te Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), duke pretenduar shkelje të lirisë së shprehjes (Neni 10 i Konventës Evropiane). Më 9 shkurt 2012, GJEDNJ vendosi njëzëri se dënimi i tyre nuk shkelte Nenin 10 – pra e mbështeti vendimin e gjykatave suedeze.

- Përgatit shpjegimin e arsyetimit kryesor të Gjykatës: (a) fletushkat përbënin sulm ndaj një grupi, jo thjesht kritikë apo debat; (b) nxënësit nuk kishin mundësi të refuzonin marrjen e materialit, pasi u vendos në dollapët e tyre pa pëlqim; (c) mosha e ndjeshme e nxënësve ishte faktor i rëndësishëm; (d) diskriminimi mbi bazë orientimi seksual u trajtua nga Gjykata po aq seriozisht sa diskriminimi mbi bazë race apo etnie.

Hapat e të nxënit

Prezantoni faktet e rastit në formë të përmbledhur (kush, ku, kur, çfarë ndodhi), pa lexuar tekstin origjinal të fletushkave fjalë për fjalë – mjafton të përshkruani natyrën e pretendimeve (denigruese, të pabazuara, që lidhnin identitetin e një grupi me sëmundje/rrezik shoqëror).

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkojuni të diskutojnë: a ishte kjo liri shprehjeje apo gjuhë urrejtjeje? Cilat elemente e bëjnë ndryshe nga një debat i ligjshëm mbi arsimin?

Pas diskutimit në grupe, prezantoni vendimin real të GJEDNJ dhe arsyetimin e saj. Krahasoni parashikimet fillestare të grupeve me vendimin real.

Diskutoni së bashku pse shkolla, si hapësirë, ndikoi te vendimi i Gjykatës – nxënësit ishin "audiencë e detyruar", pa mundësi zgjedhjeje.

Pyetje për reflektim dhe diskutim


- Pse fakti që materiali u shpërnda në një shkollë ndikoi te vendimi i Gjykatës?
- Si e dallon Gjykata "debatin e ligjshëm mbi arsimin" nga "sulmi ndaj një grupi"?
- Pse është domethënëse që Gjykata trajtoi diskriminimin mbi bazë orientimi seksual njësoj si atë mbi bazë race apo feje?
- A mendoni se dënimi ligjor është përgjigja e duhur ndaj rasteve të tilla, apo duhen edhe masa të tjera arsimore/shkollore?

Përshtatja

Situata	Përshtatja e rekomanduar
Pa internet / offline	Përgatitni paraprakisht përmbledhjen e shkruar të rastit (nga burimet e listuara më poshtë) dhe printojeni për grupet.
Online	Ndani me pjesëmarrësit linkun drejt përmbledhjes zyrtare të vendimit nga faqja e GJEDNJ (hudoc.echr.coe.int) për ata që duan të thellohen më shumë.
Mosha 15-17	Përqendrohuni te pjesa "çfarë ndodhi dhe pse ndikoi shkolla", pa u zgjatur në analizën juridike të Nenit 10.
Mosha 18-29	Shtoni diskutim mbi Nenin 10 të KEDNJ-së, konceptin e "audiencës së detyruar" dhe krahasoni me raste të tjera të GJEDNJ mbi gjuhën e urrejtjes.

Kujdes pedagogjik dhe siguri

Mos lexoni/shpërndani tekstin origjinal të fletushkave fjalë për fjalë – përshkruajeni natyrën e tyre pa e ripërsëritur gjuhën denigruese. Nëse në grup ka pjesëmarrës LGBTI (të hapur ose jo), trajtoni temën me ndjeshmëri të veçantë dhe mos i vini në pozicion të ndihen "shembull" apo "përfaqësues" të detyruar për të komentuar. Theksoni se rasti mbetet edhe sot precedent i rëndësishëm për të drejtat e komunitetit LGBTI në Evropë.



7. Paketa të gatshme për trajnim

Kombinimet e mëposhtme mund të përdoren pa e zhvilluar të gjithë pako e materialeve-in. Koha përfshin hyrjen, pushimet e shkurtra dhe vlerësimin përmbyllës.

7.1 Edukimi Medial

Paketa	Qëllimi	Mjetet	Kohëzgjatja
Ora hyrëse	Të kuptohet ndikimi i rrjedhës informative dhe të aktivizohet rutina e dyshimit.	1 + version i shkurtër i 7 + biletë daljeje	90 min
Punëtori për edukim medial	Të dallohen llojet e përmbajtjes, framing-u dhe etika.	2 + 3 + 5	3 orë
Laborator verifikimi	Të kontrollohen burimi, konteksti dhe pretendimi.	7 + 8 + 9 + 10	4-4.5 orë
Punëtori reagimi	Të zgjidhet reagimi, të shkruhet korrigjimi dhe të parandalohet manipulimi.	11 + 12 + 13	3.5 orë
Ditë e plotë	Nga konsumi kritik te reagimi i përgjegjshëm.	1 + 2 + 4 + 7 + 10 + 11 + 12	6-6.5 orë
Program dyditor / ToT	Kompetenca të plota dhe përgatitje e fasilituesve të rinj.	Dita 1: 1-6; Dita 2: 7-14 + mikro-fasilitim	2 ditë

7.2 Bullizmi kibenetik

Paketa	Qëllimi	Mjetet	Kohëzgjatja
Ora hyrëse	Të kuptohet çfarë është bullizmi kibernetik	Mjeti 15 ose 16	40 -60 min
Punëtori mbi identifikimin e bullizmit kibernetik	Kufiri mes shakasë dhe bullizmit kibernetik apo justifikimet që përdoren për të shmangur llogaridhënien si bullizues.	Zgjedhje mes mjetit 15-18. Mund të kombinohen 2 prej tyre.	40-60 min
Punëtori reagimi	Identifikimi i bullizmit kibernetik dhe format e reagimit ndaj tij.	Mjeti 19 dhe 20	30-80 min
Ditë e plotë	Cikël i plotë nga njohja me konceptin, identifikimi i situatave të ndryshme, dhe reagimi ndaj bullizmit kibernetik.	Mjeti 15, 17, 19	1 ditë
Program dyditor / ToT	Kompetenca të plota dhe përgatitje e fasilituesve të rinj.	Dita 1: 15, 17, 18 Dita 2: 19, 20, 21	2 ditë

7.3 Gjuha e urrejtjes

Paketa	Qëllimi	Mjetet	Kohëzgjatja
Ora hyrëse	Të kuptohet çfarë është gjuha e urrejtjes dhe spektri i identifikimit të saj.	Mjeti 22 ose 23	45 -60 min
Punëtori mbi identifikimin e gjuhës së urrejtjes	Të kuptohet çfarë është gjuha e urrejtjes dhe spektri i identifikimit të saj, dhe gjurma digjitale që lë.	Zgjedhje mes mjetit 22-24. Mund të kombinohen 2 prej tyre.	45-60 min
Punëtori reagimi	Identifikimi i gjuhës së urrejtjes, impakti dhe format e reagimit ndaj tij.	Mjeti 22, 25	45- 60 min
Ditë e plotë	Cikël i plotë nga njohja me konceptin, identifikimi i situatave të ndryshme, dhe reagimi ndaj gjuhës së urrejtjes.	Mjeti 22/23, 24, 25, 26	1 ditë
Program dyditor / ToT	Kompetenca të plota dhe përgatitje e fasilituesve të rinj.	Dita 1: 22/23, 24, 25 Dita 2: 26, 27	2 ditë

7.4 Shembull agjende për një ditë

Edukimi Medial

Koha	Sesioni	Metoda / mjeti
09:00-09:20	Hyrja, pritjet dhe testimi paraprak	Rregulla sigurie + Aneksi 9
09:20-10:05	Rrjedha informative	Mjeti 1
10:05-11:05	Analiza e mesazhit	Mjeti 2
11:05-11:20	Pushim	
11:20-12:30	I njëjti rast, tri paraqitje	Mjeti 4
12:30-13:15	Drekë	
13:15-14:00	Radari i sinjaleve	Mjeti 7
14:00-15:25	Dosja e verifikimit	Mjeti 10
15:25-15:40	Pushim	
15:40-16:40	Korrigjo pa amplifikuar	Mjeti 12
16:40-17:00	Testi pasues, reflektimi dhe plani personal	Anekset 9 dhe 12

Bullizmi kibernetik

Koha	Sesioni	Metoda / mjeti
09:00-09:20	Hyrja, pritjet dhe testimi paraprak	Rregulla sigurie
09:20-10:10	Personazhe të njohur dhe bullizmi kibernetik/ Pyetsor dhe skenarë mbi bullizmin kibernetik	Mjeti 15/16
10:10-10:45	Bullizëm kibernetik apo justifikime	Mjeti 17
11:45-12:00	Pushim	
12:00-13:00	Ku qëndron ti në një situatë bullizmi kibernetik	Mjeti 18
13:00-13:30	Fjalitë e keqkuptuara	Mjeti 19
13:30-14:15	Dreke	
14:15-15:25	Teatër pjesëmarrës në situatë bullizmi kibernetik	Mjeti 20
15:25-15:40	Pushim	
15:40-16:40	Simulim raportimi i bullizmit kibernetik: Si ta njohim, dokumentojmë dhe raportojmë ngacmimin online mes moshatarëve	Mjeti 21

Gjuha e urrejtjes

Koha	Sesioni	Metoda / mjeti
09:00-09:20	Hyrja, pritjet dhe testimi paraprak	Rregulla sigurie
09:20-10:10	Kush është shënjestra, analizë e rasteve të anonimizuara të gjuhës së urrejtjes	Mjeti 22
10:10-11:10	Gjurmët digjitale, si "ndjek" një postim lëndues për vite me radhë	Mjeti 23
11:10-11:20	Pushim	
11:20-12:10	Përmbajtja e gjeneruar nga IA dhe gjuha e urrejtjes nëpër platforma	Mjeti 24
12:30-13:15	"Nga ekrani im te ekrani i gjithkujt"	Mjeti 25
13:15-14:00	Dreke	
14:00-14:45	Simulim raportimi - Si të raportosh, bllokosh dhe dokumentosh abuzimin online	Mjeti 26
14:45-15:00	Pushim	
15:00-15:60	Rasti Vejdeland kundër Suedisë - Kur gjuha e urrejtjes në shkollë përfundon në gjykatë	Mjeti 27 (opsional)



8. Përfshirja e ekspertit të ftuar

Një fact-checker, gazetar, redaktor, studiues i medias, përfaqësues i platformës, mësimdhënës ose ekspert i sigurisë digjitale mund ta rrisë vlerën praktike të sesionit. Roli i ekspertit nuk duhet të jetë një ligjëratë e gjatë, por një kontribut i lidhur me detyrën e pjesëmarrësve.

Faza	Detyra e fasilituesit	Roli i ekspertit
Para sesionit	Dërgon objektivat, profilin e grupit, skenarin, kohën dhe rregullat e sigurisë. Kërkon një rast të anonimizuar dhe jo një prezantim të përgjithshëm.	Përgatit 10-15 minuta input, një shembull praktik dhe dy pyetje për grupin.
Gjatë sesionit	E prezanton shkurt, ruan kohën, lidh inputin me fletën e punës dhe shmang dominimin e diskutimit.	Shpjegon metodën e punës, demonstron një hap dhe u përgjigjet pyetjeve.
Punë në grup	E vendos ekspertin si mentor që lëviz ndërmjet grupeve.	Bën pyetje orientuese; nuk e zgjidh ushtrimin në vend të pjesëmarrësve.

Faza	Detyra e fasilituesit	Roli i ekspertit
Përmbyllja	Kërkon tri këshilla praktike dhe një gabim të zakonshëm për t'u shmangur.	Jep feedback mbi produktet dhe sqaron kufijtë profesionalë të verifikimit, reagimin mbi shkallët e bullizmit kibernetik apo gjuhën e urrejtjes.
Pas sesionit	Dërgon përmbledhje, falënderim dhe, kur është e përshtatshme, pyetje të mbetura pa përgjigje.	Mund të sugjerojë burime të sigurta dhe hapa të mëtejshëm për reagime si njoftimi institucional, adresimi me një psikolog etj.

Formati i rekomanduar: 15-20-15

15 minuta input i ekspertit; 20 minuta punë e pjesëmarrësve me rastin; 15 minuta pyetje, feedback dhe përfundime. Ky format e mban sesionin të përqendruar te të nxënit aktiv.

8.1 Pyetje për ekspertin

- Cili është hapi i parë që bëni kur merrni një pretendim të dyshimtë, apo shqyrtoni një situate të bullzimit kibernetik apo gjuhës së urrejtjes?
- Cilat janë dy gabimet më të zakonshme të të rinjve gjatë verifikimit, reagimit nga bullizmit kibernetik apo gjuhës së urrejtjes online?
- Kur thoni "nuk ka mjaft prova" në vend se të jepni verdikt?
- Si e korrigjoni një pasaktësi pa e bërë më të dukshme? Si mund të reagojnë të rinjtë ndaj shkallëve të ndryshme të urrejtjes që shohin apo ekspozohen?
- Kur një rast duhet t'i referohet një institucioni ose eksperti tjetër?



9. Vlerësimi i të nxënit

Vlerësimi duhet të matë jo vetëm njohurinë, por edhe aftësinë për të analizuar, verifikuar, argumentuar dhe reaguar. Përdorni së paku dy nga katër format më poshtë.

Forma	Kur përdoret	Çfarë mat
Test para/pas	Në fillim dhe fund të programit.	Ndryshimin në njohuri dhe vetëbesim.
Vlerësim i produktit	Pas dosjes së verifikimit, korrigjimit ose planit të reagimit.	Zbatimin e metodës dhe cilësinë e arsyetimit.
Vëzhgim i procesit	Gjatë punës në grup.	Përdorimin e provave, dëgjimin, ndarjen e roleve dhe etikën.
Vetëvlerësim / plan veprimi	Në përmbyllje.	Reflektimin dhe transferimin e aftësive në jetën e përditshme.

9.1 Rubrika e performances

Kriteri	1 - Fillestar	2 - Në zhvillim	3 - I aftë	4 - I avancuar
Formulimi i pretendimit	I paqartë ose opinion.	Pjesërisht i kontrollueshëm.	I qartë dhe i kontrollueshëm.	I saktë, neutral dhe i ndarë në nënpretendime.
Burimet	Pa burim ose vetëm një postim.	Një burim primar ose krahasim i kufizuar.	Burim primar + burime të pavarura.	Vlerëson peshën, kufizimet dhe konfliktin e interesit.
Provat dhe konteksti	Përsërit përmbajtjen.	Identifikon disa fakte, por humb kontekst.	Krahason prova dhe shpjegon kontekstin.	Kontrollon të dhëna, metodologji dhe pasiguri.
Verdikti / reagimi	Nuk lidhet me provat.	Pjesërisht i arsyetuar.	Proporcional dhe i mbështetur në prova.	I nuancuar, etik dhe minimizon dëmin.
Komunikimi	Emocional ose turpërues.	I kuptueshëm, por i paqartë.	I qartë, fact-first dhe respektues.	I përshtatur për audiencën dhe transparent mbi kufizimet.

Fletët e punës dhe anekset

Fletët mund të fotokopjohen, të plotësohen me dorë ose të kopjohen në dokumente/formularë digjitalë. Ato janë të qëllimshme të thjeshta, pa elemente grafike që vështirësojnë përdorimin.

Aneksi 1 - Ditari 24-orësh i informacionit

Përmbajtja / tema	Ku e pashë?	Kush e publikoi?	Qëllimi i mundshëm	Emocioni	Çfarë bëra?	E verifikova?

Modeli që vura re:

Pyetja	Përgjigjja ime
Cila platformë dominoi?	
Cili emocion më shtyu më shpesh të veproj?	
Sa përmbajtje kishin autor/burim të qartë?	
Zakoni që do të provoj për një javë:	

Aneksi 2 - Pesë pyetjet për mesazhin mediatik

Pyetja	Gjetjet / provat	Çfarë nuk dimë?
1. Kush e krijoi dhe kush mban përgjegjësi?		
2. Çfarë teknikash përdor për vëmendje?		
3. Si mund ta kuptojnë audiencat ndryshe?		
4. Cilat vlera/këndvështrime paraqiten dhe cilat mungojnë?		
5. Pse është krijuar: informim, bindje, shitje, argëtim, mobilizim?		

Verdikti i grupit	Arsyetimi në 2-3 fjali

Aneksi 3 - Kartat e klasifikimit të përmbajtjes

Pritini kartat. Pjesëmarrësit i vendosin në kategoritë: lajm, opinion, reklamë, satirë, propagandë ose "nuk ka mjaft informata".

Karta	Përmbajtja
Karta 1	Një artikull me autor të emërtuar, datë, dy burime dhe lidhje te dokumenti zyrtar. Titulli përmbledh gjetjen kryesore.
Karta 2	Teksti nis me "Sipas mendimit tim" dhe argumenton pse komuna duhet të ndryshojë një politikë. Është i etiketuar "Opinion".
Karta 3	Një krijues përmbajtjeje lavdëron një aplikacion dhe jep kod zbritjeje, por nuk përmend se është paguar.
Karta 4	Një faqe humori publikon lajm të ekzagjeruar, por screenshot-i shpërndahet pa emrin e faqes dhe pa shenjën e satirës.
Karta 5	Një video përdor muzikë dramatike, simbole kombëtare dhe përsërit se vetëm një grup mund ta "shpëtojë vendin", pa ofruar prova.
Karta 6	Një postim me logo të një mediaje dhe një citat të fortë, por pa lidhje, autor ose datë.
Karta 7	Një raportim i shkurtër nga një ngjarje, ku faktet dhe citatet dallohen qartë nga analiza e autorit.
Karta 8	Një artikull i shkruar si këshillë shëndeti për një produkt, me lidhje për blerje dhe pa etiketë sponsorizimi.
Karta 9	Një karikaturë përdor ironi për të kritikuar vonesat e autobusëve.
Karta 10	Një koment thotë: "Ky vendim është i gabuar dhe do të dështojë", pa pretenduar se është raportim.
Karta 11	Një faqe publikon vetëm statistikat që e favorizojnë kauzën e saj dhe i përsërit me slogan, pa treguar burimin e plotë.
Karta 12	Një video 10-sekondëshe tregon një turmë dhe mbishkrimin "kaos sot", por nuk tregon vendin, datën ose autorin.

Çelësi orientues për fasilituesin

1 lajm; 2 opinion; 3 reklamë e fshehur; 4 satirë që mund të keqinterpretohet; 5 propagandë; 6 nuk ka mjaft informata / përmbajtje e dyshimtë; 7 lajm me analizë të dallueshme; 8 reklamë native; 9 satirë; 10 opinion; 11 propagandë/advokim i njëanshëm; 12 nuk ka mjaft informata.

Aneksi 4 - Kontrolli anësor i burimit

Elementi	Çfarë gjeta?	Burimi i gjetjes	Vlerësimi
Kush e administron / autorësia			
Kontakt, adresë, përgjegjësi publike			
Historiku dhe reputacioni			
Pronësia / financimi / interesi			
Korrigjimet dhe transparenca			
Burimi primar i pretendimit			
Çfarë thonë dy burime të pavarura			

Vlerësimi para kontrollit	Vlerësimi pas kontrollit	Çfarë e ndryshoi vendimin?

Aneksi 5 - Dosja e verifikimit

Fusha	Plotëso
Pretendimi i kontrollueshëm	
Kush e bëri / ku u publikua / kur	
Pse ka rëndësi	
Çfarë do të duhej të verifikohej	

Burimi / prova	Primar apo sekondar?	Çfarë mbështet?	Kufizimet

Provat që mbështesin	Provat që kundërshtojnë	Çfarë nuk dimë

Verdikti	☐ E vërtetë ☐ E pasaktë ☐ Pjesërisht e saktë ☐ E pavërtetuar ☐ Mashtruese
Arsyetimi	

Aneksi 6 - Matrica e dëmit dhe reagimit

Pyetja	Ulët	Mesatar	Lartë
Shtrirja	Grup i vogël / pak ndërveprime	Po zgjerohet në disa kanale	Virale ose e koordinuar
Cenueshmëria	Pa person të identifikueshëm	Person/grup i identifikueshëm	I mitur, viktimë ose grup i cenueshëm
Lloji i dëmit	Konfuzion i kufizuar	Reputacion, diskriminim, privatësi	Kërcënim, panik, dhunë ose shënjestrim
Urgjenca	Mund të monitorohet	Kërkon reagim të shpejtë	Kërkon referim të menjëhershëm

Niveli i reagimit	Kur përdoret	Veprimi ynë	Kush është përgjegjës / afati
1. Mosndërveprim			
2. Korrigjim privat			
3. Korrigjim publik			
4. Raportim në platformë			
5. Dërgim te fact-checker/media			
6. Njoftim i të rriturit/institucionit			

Aneksi 7 - Korrigjimi “fact-first”

Hapi	Pyetja	Drafti ynë
1. Fakti	Cili është fakti më i rëndësishëm dhe i verifikuar?	
2. Problemi	Çfarë ishte e pasaktë, e vjetër ose jashtë kontekstit?	
3. Prova	Si e dimë? Cili burim mund të kontrollohet?	
4. Veprimi	Çfarë duhet të bëjë audienca tani?	

Kanali	Versioni
Mesazh privat (2-3 fjali)	
Koment publik (3-4 fjali)	
Postim institucional (titull + 80 fjalë)	

Aneksi 8 - Canvas-i i prebunking-ut

Fusha	Plotëso
Taktika manipuluese	
Sinjali që mund ta dallojë audienca	
Shembull i thjeshtë dhe i padëmshëm	
Pyetja mbrojtëse	
Veprimi i rekomanduar	
Mesazhi 40-60 fjalë	
Si do ta testojmë me bashkëmoshatarët?	

Aneksi 9 - Testi para/pas

Shëno: E vërtetë / E pasaktë / Nuk jam i sigurt. Përdor të njëjtat pyetje para dhe pas trajnimit.

Nr.	Deklarata	Para	Pas
1	Një përmbajtje virale është zakonisht më e besueshme se një përmbajtje me pak ndërveprime.		
2	Opinioni mund të jetë i argumentuar mirë, por nuk është i njëjtë me raportimin faktik.		
3	Një fotografi reale nuk mund të përdoret për dezinformim.		
4	Sinjalet si titulli emocional janë arsye për verifikim, jo provë automatike se përmbajtja është e rreme.		
5	Leximi anësor nënkupton kontrollimin e asaj që burime të tjera thonë për faqen ose autorin.		
6	Kur nuk ka prova të mjaftueshme, "e pavërtetuar" mund të jetë verdikti më i saktë.		
7	Korrigjimi më i mirë e vendos pretendimin e rremë në titull që të tërheqë vëmendje.		
8	Një sondazh pa numër respondentësh dhe metodologji kërkon verifikim.		
9	Detajet e çuditshme në një imazh janë prova e mjaftueshme se është gjeneruar me AI.		
10	Reagimi ndaj një pasaktësie duhet të varet edhe nga rreziku i dëmit, jo vetëm nga fakti nëse është e rreme.		

Çelësi për fasilituesin

1 E pasaktë; 2 E vërtetë; 3 E pasaktë; 4 E vërtetë; 5 E vërtetë; 6 E vërtetë; 7 E pasaktë; 8 E vërtetë; 9 E pasaktë; 10 E vërtetë.

Aneksi 10 - Formulari i feedback-ut

Vlerëso nga 1 (aspak) deri në 5 (shumë).

Deklarata	1	2	3	4	5
Objektivat e sesionit ishin të qarta.					
Ushtrimet më ndihmuan ta zbatoj njohurinë në praktikë.					
Shembujt ishin të kuptueshëm dhe relevantë.					
Fasilituesi krijoi hapësirë të sigurt dhe respektuese.					
Puna në grup kontribuoi në të nxënit tim.					
Tani ndihem më i/e aftë të analizoj një mesazh mediatik.					
Tani ndihem më i/e aftë të verifikoj një pretendim.					
Tani di të zgjedh një reagim më të përgjegjshëm.					

Pyetja e hapur	Përgjigjja
Cila pjesë ishte më e dobishme?	
Çfarë duhet përmirësuar?	
Cilin mjet do ta përdorësh në shkollë/ komunitet?	
Çfarë pyetjeje ka mbetur pa përgjigje?	

Aneksi 11 - Lista e kontrollit për fasilituesin

Faza	Kontrolli
Para sesionit	☐ Kam përcaktuar rezultatet e të nxënit dhe mjetin e duhur
	☐ Materialet janë të simuluara ose të anonimizuara.
	☐ Kam kontrolluar faktet, burimet dhe datat e shembujve.
	☐ Ekziston variant offline nëse interneti dështon.
	☐ E di si do të reagoj nëse shfaqet rast real ose përvojë personale.
Gjatë sesionit	☐ Kam vendosur rregullat e sigurisë dhe privatësisë.
	☐ Nuk turpëroj përgjigjet e pasakta.
	☐ Ndaj vëzhgimin, pretendimin dhe provën.
	☐ I jap kohë të mjaftueshme reflektimit, jo vetëm aktivitetit.
	☐ Siguroj që të gjithë të kenë rol dhe mundësi për kontribut.
Pas sesionit	☐ Kam mbledhur testin/feedback-un.
	☐ Kam sqaruar burimet dhe kufijtë e ushtrimit.
	☐ Kam hequr ose ruajtur në mënyrë të sigurt materialet e ndjeshme..
	☐ Kam shënuar çfarë duhet përshtatur për sesionin e ardhshëm.

Aneksi 12 - Plani personal "Mëso - Praktiko - Ndaj"

Hapi	Pyetja	Plani im
Mëso	Cila aftësi dua ta forcoj në 30 ditët e ardhshme?	
Praktiko	Në cilën situatë do ta përdor? Sa herë?	
Ndaj	Me cilin grup, klasë ose organizatë do ta ndaj?	
Mbështetje	Cili ekspert, mësimdhënës ose organizatë mund të më ndihmojë?	
Mat	Si do ta di që kam përparuar?	
Hapi i parë	Çfarë do të bëj brenda 7 ditësh?	

Aneks 13 Kartat e Situatave Fiktive - Bullizmi Kibernetik

(8 karta, nga niveli më i lehtë te më i rëndë. Çdo kartë mund të printohet veçmas dhe t'i shpërndahet një çifti/grupi. Të gjitha emrat dhe detajet janë fiktive.)

KARTA 1 – Niveli: I lehtë

Situata:

Rina dhe Elira janë shoqe të ngushta prej vitesh. Pas një mosmarrëveshjeje për një projekt shkolle, Elira i shkruan Rinës në një mesazh: *"S'e prisja këtë prej teje, m'u desh të bëja gjithçka vetë."* Rina përgjigjet e mërzitur, dhe të dyja s'flasin për dy ditë. Më pas, Elira i shkruan përsëri për t'u sqaruar.

Pyetje për grupin:

- A është ky bullizëm kibernetik apo konflikt i zakonshëm mes shoqeve? Pse?
- A duhet dokumentuar kjo situatë?
- A ka nevojë për ndërhyrjen e një të rrituri?

KARTA 2 – Niveli: i lehtë-mesatar

Situata:

Glauk vëren se është hequr papritmas nga grupi i klasës në Viber, ku organizohen aktivitete jashtëshkollore. Askush s'i jep shpjegim. Kur pyet një shok, merr përgjigjen: *"S'e di, ndoshta gabim teknik."* Kjo ndodh vetëm një herë dhe të nesërmen e shtojnë sërish në grup pa shpjegim.

Pyetje për grupin:

- Si ndiheni për këtë situatë – a duket si gabim i rastësishëm apo diçka e qëllimshme?
- Çfarë do të bënit nëse do të ishit Glauk?
- Në cilën pikë një "rast i vetëm" fillon të duket si model i përsëritur?

KARTA 3 – Niveli: Mesatar

Situata:

Një grup nxënësish të klasës së 12-të krijojnë një grup të veçantë në Instagram, pa e ftuar qëllimisht një bashkënxënës, Blerimin. Në grup, ata postojnë rregullisht foto dhe video duke bërë shaka për mënyrën se si flet apo vishet Blerimi, pa e etiketuar drejtpërdrejt, por të gjithë e dinë për kë bëhet fjalë. Kjo ndodh çdo javë prej muajsh.

Pyetje për grupin:

- Cilat elemente e bëjnë këtë bullizëm kibernetik (jo thjesht "shaka")?
- A duhet Blerimi ta dokumentojë këtë, edhe pse s'është drejtpërdrejt i etiketuar?
- Kush duhet përfshirë: shkolla, prindërit, apo mjafton vetë raportimi te platforma?

KARTA 4 – Niveli: Mesatar

Situata:

Dikush krijon një llogari false në TikTok me emrin "Vjollca_e_vertete", duke përdorur një foto të vjetër publike të Vjollcës (marrë nga profili i saj) dhe duke postuar video herë herë që e bëjnë atë të duket qesharake apo budallaqe, me titra fyes. Llogaria fillon të ndiqet nga disa bashkënxënës të saj, të cilët komentojnë dhe qeshin.

Pyetje për grupin:

- Çfarë hapash konkretë duhet të ndërmarrë Vjollca (dokumentim, raportim, bllokim)?
- A mjafton raportimi te vetë platforma për të hequr llogarinë false, apo nevojitet edhe diçka tjetër?
- A duhet përfshirë shkolla në këtë rast, edhe pse ndodh "online"?

KARTA 5 – Niveli: Mesatar-i lartë

Situata:

Një video private, e xhiruar nga një shok gjatë një feste ditëlindjeje, ku dikush rrëzohet dhe qesh vetë për këtë, përhapet në grupin e klasës pa lejen e personit. Brenda ditës, videoja arrin edhe në grupe të tjera të shkollës me komente përqeshëse. Personi në video kërkon të hiqet videoja, por disa vazhdojnë ta ridërgojnë "për humor".

Pyetje për grupin:

- Pse fshirja e kërkuar nga personi shpesh nuk mjafton për ta ndaluar përhapjen?
- Çfarë duhet dokumentuar në këtë rast (kush e ka postuar fillimisht, kush e ka ridistribuar)?
- A ka këtu përgjegjësi kolektive te ata që e ridërguan videon, edhe nëse s'e filmuan vetë?

KARTA 6 – Niveli: I lartë

Situata:

Një nxënës që ka dënuar më parë bullizmin kibernetik ndaj tij merr mesazhe të përsëritura nga një llogari anonime në Instagram (jo shok i njohur, por dikush që duket se e njeh shkollën) me përmbajtje kërcënuese: "*E dimë ku banon, ki kujdes.*" Mesazhet vijnë çdo ditë prej një jave, gjithnjë nga llogari të reja pasi bllokohen paraardhëset.

Pyetje për grupin:

- Cilat elemente e bëjnë këtë situatë të një niveli tjetër rreziku krahasuar me kartat e mëparshme?
- A mjafton bllokimi i llogarisë, apo nevojitet menjëherë përfshirja e prindërve/Policisë?
- Çfarë duhet dokumentuar patjetër përpara se të bllokohet çdo llogari e re?

KARTA 7 – Niveli: I lartë (me elementë të gjuhës së urrejtjes)

Situata:

Një nxënëse nga komuniteti Rom/Ashkali/Egjiptian bëhet objekt i një "chat-i grupi" të krijuar posaçërisht kundër saj në shkollë, ku disa bashkënxënës shkëmbejnë mesazhe dhe meme që përqeshin origjinën e saj etnike, duke përdorur terma përçmues. Ajo e sheh një screenshot të tij të dërguar nga një shoqe.

Pyetje për grupin:

- Si ndryshon ky rast nga kartat e tjera, çfarë shtese sjell elementi i identitetit etnik?
- A duhet trajtuar ky rast vetëm si "bullizëm mes nxënësish", apo edhe si çështje diskriminimi?
- Cilat institucione konkrete në Kosovë mund të përfshihen këtu (shkolla, Avokati i Popullit, Komisioneri kunder diskriminimit)?

KARTA 8 – Niveli: I lartë (sulm i koordinuar / "pile-on")

Situata:

Një nxënës publikon rastësisht një foto private në "story" të tij, e cila kapet me screenshot dhe ridërgohet në një faqe anonime tip "confession" të shkollave të qytetit. Brenda orësh, dhjetëra përdorues të panjohur (jo vetëm bashkënxënës) fillojnë të komentojnë me sharje dhe të "etiketojnë" llogari të tjera për ta bërë publik rastin. Personi merr qindra mesazhe dhe komente brenda një dite.

Pyetje për grupin:

- Si dallon "pile-on" nga bullizmi i zakonshëm mes dy-tre personash?
- Çfarë mund të bëjë realisht personi i prekur kur numri i personave përfshirë është kaq i madh?
- Në këtë rast, a mjafton përfshirja e shkollës, apo duhet menduar edhe për Policinë, duke pasur parasysh shkallën e përhapjes?

Aneks 14 - "Postimi Shembull" + Menuja e Raportimit

FLETA A - Postimi (të printohet e para)

@perdorues_fiktiv123

[FOTO/POSTIM FIKTIV]

"Ky komunitet gjithmonë sjell probleme, s'kanë vend këtu..."

♡ 45 💬 12 komente ↗ Shpërndaj

[⋮ Më shumë]

Instruksion për fasilitatorin: Tregoju grupit se butoni "⋮ Më shumë" (tri pikat) është vendi ku fillon çdo raportim, në pothuajse çdo platformë.

FLETA B - Menuja që hapet pas "⋮ Më shumë"

Çfarë dëshiron të bësh me këtë postim?

- 🏳 Raporto këtë postim
- 🔕 Hesht (mos e shfaq më)
- 🚫 Blloko @perdorues_fiktiv123
- 📋 Kopjo lidhjen (për ta ruajtur)

FLETA C - Hapi "Raporto" → Zgjedhja e arsyes

Pse po e raporton këtë postim?

- ○ Ngacmim ose sulm personal
- ○ Gjuhë urrejtjeje ose diskriminim
- ○ Kërcënim me dhunë
- ○ Informacion personal i ndarë pa leje
- ○ Diçka tjetër

[Vazhdo →]

FLETA D - Konfirmimi final

☑ Faleminderit! Raporti u dërgua.

Ekipi ynë do ta shqyrtojë brenda 24-48 orësh.

A dëshiron gjithashtu ta bllokosh këtë përdorues?

[Po, bllokok] [Jo, mjafton]

Trg BiH 1/V, Sarajevo
Bosnia and Herzegovina

Fax: +387 33 561 701
Phone +387 33 561 700

mail: rcc@rcc.int
website: www. rcc.int



RegionalCooperationCouncil



regionalcooperationcouncil_rcc



Regional Cooperation Council



@rccWBYL



RCCSec



rcc.int